

**INSTITUCION PUBLIK KOMUNAL KOPSHTI
PËR FËMIJË**

“OLLGA MICESKA” KËRÇOVË

**PROGRAM VJETOR
PËR PUNË PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023**

Kërçovë, Shtator viti 2022

Në bazë të nenit 121 alinea 2 pika1 dhe nenit 168 alinea 1 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve “Fletorja zyrtare e RM” – tekst I spastruar 2017, drejtori i I P K K F – Kopshti i fëmijëve “Ollga Miceska” Kërçovë në datë 09.08.2022 solli:

PROGRAM VJETOR

Për punë në I P K K F – Kopshti i fëmijëve “Ollga Miceska” për vitin shkollor 2022/2023

Hyrje

Këtu janë konkretizuar aktivitetet në nivelin e kopshtit, aktivitetet e planifikuara ku programa vjetore është dokumenti më i rëndësishëm për punën e kopshtit. Në këtë dokument janë cekur udhëzimet kryesore që kopshti duhet të ndjekë gjatë vitit shkollor për ofrimin e mbështetjes dhe arsimimit të fëmijëve dhe familjeve, numrin e planifikuar gjatë vitit, planet për ndryshimin dhe përmirësimin e kushteve të qëndrimit në kopsht, si dhe përgjegjësitë e subjektit kopsht.

Duke u nisur nga më herët, si dhe detyrimet ligjore (Ligji për mbrojtjen e fëmijëve për miratimin e këtij dokumenti, përgatitja e Programit Vjetor bazohet në Programin e Mësimin të hershëm (miratuar nga MPPS nga 01.09.2014), e cila nga ana e saj fillon nga Standardet për mësimin e hershëm dhe zhvillimin e fëmijëve nga 0-6 vjeç që promovojnë qasjen holistike gjithëpërfshirëse në inkurajimin e mësimin dhe zhvillimit të hershëm të fëmijët e vegjël dhe kushtet e parashikuara nga kopshti për realizim të objektivave, detyrave dhe përmbajtjes së programit.

Programa gjithashtu përfshin efektet dhe përmbajtjet pozitive që realizohen në kopshtin e fëmijëve nga:

- Programet arsimore për fëmijët parashkollorë të miratuara nga MPPS:
- "Integrimi i arsimit ekologjik në sistemin arsimor në Maqedoni";
- "Programi arsimor për fëmijët parashkollorë me procesin e rritjes dhe konsumimit të ushqimit të shëndetshëm" dhe
- "Paraqitja e respektit për diversitetin dhe multikulturalizmin"
- Udhëzime për planifikimin e veprimtarive të programit të mësimin të hershëm dhe zhvillimit dhe arritjen e standardeve të mësimin të hershëm dhe zhvillimit:
- "Lojëra tradicionale në institucion";
- "Sporti dhe aktivitete sportive" dhe
- "Fitimi i shprehive të shëndetshme dhe sjelljes së sigurt"
- Përmbajtja sipas projektit:
- "Qyteti në sytë të fëmijëve"
- "Bonton për fëmijë"
- "Nga fëmija tek fëmija"
- "Riciklimi me imagjinatë"

- "Familja dhe vlerat familjare"
- "Higjiena ime – shprehja ime"

Edukatoret, kujdestaret dhe fëmijet kanë role të barabarta aktive në procesin e mesimit të hershëm dhe zhvillimin e fëmijëve.

Nuk ka përgjigje të vetme në pyetjen dhe në cilën mënyrë fëmijët e vegjël do të mësojnë më mirë. Por një është e sigurt në procesin e mesimit të hershëm edhe edukatorët edhe fëmijët e vegjël kanë rol aktiv.

Numër i madh hulumtimesh janë të lidhura me zhvillimin e fëmijëve që vërtetojnë përvojat me të cilat fëmijët ballafaqohen gjatë fëmijërisë së hershme që paraqesin moment kritik për suksesin e kohëzgjatur në përgjithësi në jetë. Përgjegjësia për sigurinë e ambientit në përgjithësi që përmban përgjegjësi pozitive në rrjedhën e fëmijërisë së hershme e përbëjnë shumë faktorë: duke filluar nga prindërit/tutorët, edukatorët dhe arsimtarët dhe bashkësia më gjerë. Të gjithë ato kanë rol të barabartë për nxitjen e rritjes dhe zhvillimit të fëmijët e vegjël si dhe kreativitetin e mundësive për ndërtimin e shkathtësive të cilat i përgatisin fëmijët më lehtë të adaptohen në provokimet e botës që i rrethon.

Prej atyre del nevoja e kreativitetit të ambientit për mesim të hershëm nga ana e të gjithë atyre që kujdesen për fëmijët e vegjël, a që është në përputhje me interesat e fëmijëve për mesim dhe ndërtohen për atë që fëmijët atë më e dinë.

Ambienti stimulativ për mesim të hershëm e përparon zhvillimin e hershëm dhe nxit shkathtësi për kritika dhe mendim kreativ të fëmijët, fëmijët bëhen të vetëdijshëm për multikulturalizmin dhe ekzistimi i llojshmërisë e forcon procesin gjithëpërfshirës të mesimit të hershëm të tyre. Zhvillimi i hershëm i fëmijëve në çdo domen të zhvillimit (fizik, socio-emocional, kognitiv dhe gjuhësor) përkrahet, nxitet dhe forcohet, primare nëpërmes aktiviteteve të cilat promovojnë drejtime lojërash në kornizat e rrethit në të cilin fëmijët qëndrojnë. Por rrethi në të cilin fëmija qëndron duhet të begatojë si me struktura ashtu edhe me lojëra jostrukturale (aktivitete) për mesim. Lojrat jostrukturale marrin pjesë të konsiderueshme të ditës ndërsa aktivitetet strukturale kyçen aktivitetet rutinore të ditës (gjatë pranimit në kopsht, gjatë kohës së racioneve, gjatë kohës së përgatitjes për pushim, dhe fjetje) si dhe aktiviteteve për mesim i cili shoqërohet në kornizat e përmbajtjes së planit programor. Edhe për aktivitetet struktural dhe jo struktural ambienti për mesim duhet të jetë i përshtatshëm, i siguruar, i pastër, i ngrohtë dhe stimulativ. Gjatë kreirimit të ambientit që e nxit zhvillimin e mesimit të hershëm të fëmijët e vegjël duhet që të ketë parasysh tre principe (shtylla) bazë:

- Zhvillimi të fëmijët shpaloset sipas zhvillimit të hershëm të arriturat të cilat ngadalë bëhen më komplekse, më të organizuara dhe me paraqitje individuale të zhvillimi i çdo fëmije.
- Loja dhe forca e lëvizjes për nxitjen e zhvillimit të çdo fëmijë, përfshi edhe fëmijët me zhvillim të rëndë (ngadalësuar).
- Ambienti efektiv për të mësuar arrihet kur kombinohen aktivitetet për mesim i iniciuar prej fëmijëve dhe të udhëhequr nga të rriturit ose të kundërtën. Në atë proces, as të rriturit e as fëmijët kanë përjashtim pasiv apo përjashtim aktiv të rolit.

Programi efektiv për nxitjen e mësimin të hershëm të fëmijët e vegjël shumë herë kombinohet dhe përmbajnë aktivitete të cilat janë në të njëjtën kohë të orientuara nga të rriturit (edukatorët, prindërit) dhe vetë fëmijët.

Bazat kalimtare për organizimin e veprimtarisë

Dijenitë bashkëkohore të shkencës dhe të arriturat e psikologjisë dhe pedagogjisë, si dhe disiplina të tjera të ngjashme shkencore, tregojnë se domethënia e fëmijërisë së hershme për zhvillimin intelektual, zhvillimin social dhe emocional dhe me të është rëndësia e dhënies së kushteve për atë zhvillim.

Programi vjetor është i koncentruar në bazë të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve si dhe të drejtën kushtetuese dhe obligimet e qendrës të bëjë programimin e punë së vet, dhe ajo e merr si bazë në programimin e punës, për arritjen e rezultateve më kualitativ të veprimtarisë, si dhe mbulimin e nevojshëm të transformimit në organizatën parashkollore, sjell dhe ndërrime në planifikimin dhe programimin në punë dhe të arriturat në kujdesin e edukimit të programit arsimor.

Programi vjetor i qendrës themelohet mbi bazat kalimtare të rregulluara me Ligjin për mbrojtje e fëmijëve neni 59,si dhe me programin për edukim-arsimin të veprimit parashkollor për edukim dhe arsimim në Çerdhet publike për fëmijë në të cilën është përmbajtja e strukturës programore për kujdesin dhe punën për arsim dhe edukim.

Ky dokument programor themelohet në përputhje me kuptimet e sjella nga analizat e programeve dhe dokumenteve të ma përparshëm, dhe në të janë të futura dijenitë shkencore-profesionale për dijenitë intelektuale dhe potencialit mendor të fëmijët të moshës nga 9-muaj deri në 5 vjet, efektet pozitive prej realizimit të projektit “ Hap pas hapi” si dhe nga projekti “Arsimim qytetar”, “ Kalimi kah mendimet vizuale” dhe “ Inkluzimi i fëmijëve me nevoja të posaçme ne shkollat e rregullta”.

- Programi jashtinstitucional i arsimimit dhe edukimit si formë e gjetjes së përmbajtjeve të reja për përfshirjen e fëmijëve me qëndrim më të shkurtër për zhvillim psikofizik në rrethin më të afërt, që nuk përfshihet me format egzistuese për kujdes, edukim dhe arsimim për të njëjtët;

-Prania është e përhershme dhe nevoja për multicitetin të formave dhe përmbajtjen që përfshin gjeneratat e të vegjëlve në shumë sekuenca (prania tërë ditore në kopsht, gjysmë ditore dhe ngjashëm sipas nevojave dhe kërkesave të prindërve);

-Literatura pedagogjike që sillet për edukimin dhe fëmijën parashkollor (pedagogjinë-psikologjinë parashkollore);

-Në procesin e organizimit të edukim-arsimit dhe kujdesi i punës, fillon nga fëmija si personalitet që i ka aftësitë e veta, mendimet e veta, shprehitë dhe qëndrimet. Duke u nisur nga dijenitë pedagogjike – psikologjike për zhvillimin e fëmijës, do të ndikojë në zhvillimin, fizik, emocionet sociale dhe në zhvillimin intelektual social të fëmijës.

Bazat kalimtare për organizimin e veprimtarisë dalin edhe prej qëllimeve dhe detyrave të edukimit dhe arsimimit parashkollor,të cilat qëllime dhe detyra do të jenë lëndët për realizimin e programit të vitit 2022/2023 dhe ato janë: të kultivojë dhe të nxisë

orientim fisnikërie zhvillimin e gjithanshëm të personalitetit të fëmijës në edukimin me karakteristikat psikofizike dhe mundësitë individuale të fëmijës.

Qëllimet praktike dhe detyrat janë të përfshira me programin që do të jenë lëndë për realizim në vitin tjetër shkollor dhe do të tentohet të fëmijët e vegjël të sigurohet në mënyrë të drejtë:

- a) zhvillim fizik dhe senzomotorik të fëmijët;**
- b) zhvillim social-emocional të fëmijët,dhe**
- c) zhvillim vetëdije intelektuale të fëmijët.**

a) Zhvillimi fizik dhe senzomotorik të fëmijët të zhvillohet edhe atë:

- të mundësohet rritje normale dhe zhvillim i organeve dhe funksionimi i tyre,
- të forcojë shëndetin trupor të fëmijës dhe ta mbrojë prej sëmundjeve dhe lëndimeve,
- të nxis zhvillimin e aftësive lëvizëse dhe përvetësimin e motorikes.
- ta orientoj në zhvillimin e plotë senzomotorik,
- ti zhvillojë shprehitë bazë të mbajtjes së higjienës trupore, marrjen e ushqimit dhe kryerjet nevojave fiziologjike.

b) Zhvillimi social-emocional:

- të ndikohet të fëmija gradualisht të zhvillohet ndjeshmëri të sjelljes individuale dhe nevojë për kontakt me persona të tjerë.
- ta përkrahin drejtpërdrejt dhe sinqerisht fëmijën në kontakt me botën,
- të sigurohen kushte për formimin e kënaqësive dhe fëmijë fatlum,
- të kontribuohet në vetëvendosje të fëmija dhe vetëmbrojtje,
- të kontribuohet të fëmija për përjetimet e aktiviteteve individuale dhe kolektive,
- ti ndihmojë fëmijës për përvetësim të rregullave themelore në sjellje me moshatarët dhe më të rriturit.

c)Zhvillimi i vetëdijes-intelektuale:

- ta nxisë për përkrahje të kureshtjeve natyrore të fëmijës rreth botës që e rrethon,
- të përkujdesej në ndjeshmërinë e fëmijës për marrje të mbresave,
- të përkrahi komunikimin e të folurit të fëmijës dhe gradualisht ta kultivojë dhe pasurojë zhvillimin e vet,
- ta orientojë zhvillimin e percepcionet senzomotorike të aftësive të fëmijës,
- ta nxisë të zgjidhi probleme të vogla intelektuale senzomotorike,
- të formojë kushte të dashamirësisë për formimin e dashamirësisë dhe kuptimit të vetëdijes përmes aktiviteteve praktike të fëmijëve.

KUSHTET NË PUNË DHE ORGANIZIMI I VENDOSJES

1. Përshkrimi dhe lokacioni i objektit dhe oborri

Mbështetja veprimtare e këtij viti do të kryhet në qendrën amë me dy njësi në përbërje të vet. Të tre objektet përbëjnë njësi më vete, të caktuara dhe të ndërtuara nga materiali i fortë. Qendra amë ndodhet në rrugën 11-Shtatori nr. 89 në regjionin qendror të qytetit në afërsi të Sh F” K. J. Pitu”, njësia “Lulet” në rrugën “Trpe Bllazheski Trifko” pa numër, në afërsi të Sh F “ V. Polezhinoski”, ka periferia e qytetit në largësi përafërsisht 1 km. prej qendrës amë, kurse njësia “Dallëndyshet” ndodhet në rr.”Zagorje” pa numër në lagjen Balla Mëhallë,në afërsi të shkollës së re fillore SHF “ Sande Shterjoski” përafërsisht 2 km larg qendrës amë.

Objekti i qendrës amë IPK- Çerdhja e fëmijëve “OLLGA Miceska” Kërçovë, disponon me një sipërfaqe prej 6.391 m2 prej ku 4786 m2 është sipërfaqe oborri,a pjesa

tjetër, ose 1.605 m² është sipërfaqe e brendshme e përdorur. Sipërfaqja e brendshme përbëhet nga 6 klasa pune , 3 salla, 6 zyra, magazinë, kuzhinë, kazani me vend për larje. Me kapacitet për 120 fëmijë.

2.1. Kushtet hapësinore në IPK-Çerdhja e fëmijëve “Ollga Miceska” Kërçovë

a) dhomat për përkujdesje dhe veprimtari edukuese-arsimore

N. ren	Lloji i dhomave	numri	m ²	Vërejtje
1.	Zbavitje - dhoma e fëmijëve	1	35	-
2.	Dhoma e gjumit-dhoma e fëm.	1	35	-
3.	Zbavitje-çerdhja e fëmijëve	5	175	-
4.	Dhoma e gjumit çerdhja e fëm.	5	175	-
5.	Salla e fiskulturës	-	-	-
6.	Biblioteka	-	-	-
7.	Dhoma për ruajtjen e mjeteve audiovizuale	1	35	kabinet
.	Gjithsej:	13	455	

b) Dhomat për veprimtari shoqërore dhe pedagogjike

N.ren.	Lloji i dhomave	numri	n ²	Vërejtje
1.	Dhoma e drejtorit	1	25	-
2.	Dhoma e pedagogut Dhoma e administratës	1	25	-
3.	Dhoma për Ped. Motra med.	1	25	-
4.	Dhoma e arkëtarit	1	12	-
5.	Dhoma e edukatoreve	1	25	-
6.	Dhoma për prog. kult. artistik	-	-	Shfr. trapezaria
7.	Dhoma tjera (magazina)	4	85	-
	Gjithsej:	10	222	

c) Dhomat për nevoja sanitare dhe shëndetësore dhe të tjera dhoma ndihmëse

N.ren.	Lloji i dhomave	numri	m ²	Vërejtje
1.	Dhoma për praninë dhe përc.	-	-	-
2.	Dhoma për vizitë mjekësore	-	-	Prej mot. Med.
3.	Kuzhina	1	70	-
4.	Trapezaria	1	120	-

5.	Korridoret	3	330	-
6.	Korridore të tjerë	2	100	-
7.	Shkallët	-	-	-
8.	Strehimore	-	-	-
9.	Nyje sanitare	6	120	-
10.	Tjera nyje sanitare	2	18	-
11.	Tj.(dh.për larje,hekur.kazani)	3	170	-
	Gjithsej	18	928	

Deri në vitin 2002 njësia “Lulet” dispononte me një sipërfaqe shfrytëzuese prej 1800 m² prej kujt 600 m² u adaptuan për fëmijë me nevoja të veçanta, të cilat i shfrytëzon Qendra për punë sociale në Kërçovë.

Njësia “Lule” tash disponon me 4.275 m² vend oborri dhe 1.200 m² sipërfaqe të brendshme. Disponon me 4 klasa ose qëndrime, trapezari,kuzhinë e pajisur, zyra, kazan me vend larje dhe magazinë. Kapaciteti është për 120 fëmijë.

II. Dhomat(hapësirat) dhe kushtet në njësinë “Lule”

a) Dhomat(hapësirat) për përkujdesjen dhe veprimtarinë edukative-arsimore

N.ren.	Lloji i dhomës	numri	m2	Vërejtje
1.	Dhomat për zbavitj- çer.e fëm.	4	240	-
2.	Dhoma gjumi-çerdhja e fëm.	4	240	-
3.	Salla të fizkulturës	-	-	-
4.	Biblioteka	-	-	-
5.	Hapësira për ruajtjen e mjeteve audiovizuale	1	20	zyra
	Gjithsej	13	500	

b) Dhomat për veprimtari shoqërore dhe pedagogjike

N.rend.	Lloji i dhomave	Numri	m2	Vërejtje
1.	Zyra e drejtorit	-	-	-
2.	Zyra e pedagogut	1	20	-
3.	Dhoma për prog.kult.artistik	1	100	-
4.	Dhoma të tjera(magazina)	1	20	-
	Gjithsej	3	140	-

c) Dhomat për nevoja shëndetësore sanitare dhe të tjera dhoma ndihmëse

N. ren.	Lloji i dhomës	numri	m2	Vërejtje
1.	Kuzhina	1	70	-
2.	Korridore	3	280	-
3.	Strehimore	-	-	-
4.	Nyje sanitare	6	120	-
5.	Nyje tjera sanitare	2	10	-
6.	Tj(vendi për larje hekurosje	3	80	-

	kaldaja)			
	Gjithsej	15	560	-

Më datë 2.9.2019 u hap edhe objekti i ri i kopshtit për fëmijëve “Dallëndyshet” e lokalizuar në rrugën “Zagorje” pa numër, në lagjen “Balla Mëhallë” në Kërçovë - Komuna e Kërçovës që do të shfrytëzohet për përkujdesjen dhe edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore (moshë prej 9 muaj deri 6 vjet).

Objekti disponon me kapacitet për përkujdesjen e 120 fëmijëve, ku do të përfëshihen në 6 grupe.

Objekti i plotëson të gjitha kushtet-standartet dhe pajisjet plotësuese (kuzhinë e re, tabelat ndarëse në tualet, krevatët dhe pajisjet didaktike) dhe është gati për funksionim normal për punë.

Objekti posedon sipërfaqe të shfrytëzueshme neto të objektit prej 812,8 m2 dhe oborr prej 9349 m2.

Objekti disponon me hapësirat vijuese:

III. Dhomat(hapësirat) dhe kushtet në njësinë “Dallëndyshet”

a) Hapësira të përbashkëta dhe komunikim

N.ren.	Lloji i dhomës	numri	m2	Vërejtje
1.	Hyrje kryesore	1	20,6	-
2.	Korridori	1	236,3	-
3.	Hyrje ndihmëse	2	13,4	-
4.	Dhomë ngrënie	1	60,5	-
5.	Kuzhinë	1	21,7	-
6.	Hapësirë ndihmëse	1	12,2	-

b) Hapësira ndihmëse ,hapësira për të punësuarit/personeli/administratë

N.ren.	Lloji i dhomës	numri	m2	Vërejtje
1.	Parahapësirë	2	19,5	-
2.	Zhveshtore për femra me dush	1	7,4	-
3.	Tualet për femra	1	2,4	-
4.	Zveshtore për meshkuj me dush	1	7,4	-
5.	Tualet për meshkuj	1	2,4	-
6.	Lavanderi	1	13,8	-
7.	Dhoma e kazanit/bojlerit	1	21,8	-
8.	Zyra e Drejtorit	1	12	-
9.	Ambulanca	1	13,2	-
10.	Hapësirë për të punësuarit	1	15,6	-
11.	Tualet për të punësuarit	1	5,8	-

c) Hapësira/ kënde edukate/zbavitëse/sanitari

N.ren.	Lloji i dhomës	numri	m2	Vërejtje
1.	Mësonjtore/këndi	6	251,8	-

2.	Lavabo	6	32,9	-
3.	Tualete	6	42,1	-

Të tre objektet plotësisht përgjigjen në pajtim me normativat për parashkollorët për edukim dhe arsimim. Hortikultura është e rregulluar rreth të tre objektet, që do të thotë se është mbjellë bar, dru të ulët (driza), pisha dhe të tjera. Sipërfaqet e oborrit shfrytëzohen për orët në natyrë, për realizimin e orëve të edukatës fizike, shëtitje në ajër të pastër dhe ashtu me radhë.

d) Oborret dhe sipërfaqe të tjera

N.ren.	Lloji i dhomës	Numri	n2	Vërejtje
1.	Rregullimi i sipërfaqeve të oborrit(Hortikultura)	3	10.661	Për të tre çerdhet
2.	Jo të rregulluara sipërfaqe	-	-	
3.	Rregullimi i rafteve	-	-	-
4.	Hapësira tjera,(tarraca)	14	420	-
	Gjithsej	17	11,081	-

e) Pajisja me inventarin themelues dhe mobilie

- pajisja dhe mobilje për fëmijët e çerdhes
- pajisja dhe mobilje për fëmijët e kopshtit

(**Vërejtje:** Realizimi i programit “ Hap pas hapi” çerdhja e fëmijëve është pajisur me elemente dhe parmakë për formimin e kateve. E njëjta sillet edhe për grupet tjera të çerdhes së fëmijëve. Por në pamje prej atëherë ka kaluar kohë e gjatë dhe të gjitha janë të vjetruara dhe disa krejtësisht të shkatërruara. Varet prej mundësive të qendrës ose prej mjeteve të tjera këtë vit shkollor do të mundohemi diçka të rinovojmë.)

Në kuadër të IPKKF “Ollga Miceska” Kërçovë funksionon grupa në kushte tjera hapësinore në Komunën e Pllasnicës me kapacitet prej 25 fëmijëve. Grupa është heterogjene me fëmijë të moshës prej 3-6 vjeç.

f) Të punësuar në IPKKF “Ollga Miceska” Kërçovë

Në kopshtin e fëmijëve në afat të pacaktuar janë të punësuar 50 persona prej të cilëve:

- * 1 drejtor
- * 1 bashkëpunëtor profesional
- * 10 edukatore
- * 21 përkujdesëse
- * 1 kontabilist
- * 1 arkëtar
- * 1 vozitës furnitor
- * 1 mjeshtër për mirëmbajtje të nxemjes qëndrore
- * 2 kuzhinier
- * 1 ndihmës kuzhinier
- * 6 pastruese
- * 1 mjeshtër shtëpiak

- * 2 enëlarës
- * 1 larese-hekurose

Prej 50 të punësuarve:

- * 23 të punësuar janë të nacionalitetit maqedonas
- * 18 të punësuar janë të bashkësisë etnike shqiptare
- * 9 të punësuar nga bashkësia etnike turke

1. Lojërat dhe materiali didaktik

Grupi prej dhomave të fëmijëve është e pajisur me materiale didaktike të cilat më të theksuara janë ata të ashtu quajtura tuberët të formave dhe ngjyrave të ndryshme, që do të thotë që të njëjtat janë të përshtatura për moshën e fëmijëve. Po ashtu si material didaktik trajtohen të ashtu quajturit dyshekët që përdoren për lojëra të lëvizshme, rrëshqitja e fëmijëve gjatë fillimit të lëvizjeve dhe të ngjashme. Në çerdhe ka edhe fotografi fëmijësh, kafshë të sfungjerit dhe të ngjashëm por jo edhe në numër të mjaftueshëm.

2. Pajisja e çerdhës me kënde përkatës

Çerdhja është e pajisur me raftet në vijim: të literaturës, familjarizimit, konstruktivit, komunikacionit, muzikës dhe matematikës. Të gjitha raftet janë të pajisur me material të njëjtë fëmijëror, i cili është i ndarë në rafte. Në raftet familjar rrinë elementet që shërbejnë në shtëpi, kuzhinë dhe të njëjtë, disa janë të dëmtuar dhe duhej të ndërrohen me të rinj.

3. Ndhimesat teknike dhe të Audiovizualitetit

N.ren.	Lloji i mjeteve	Gjithsej numri	Gjendja		Shfrytëzimi	
			Në rreg.	Jo në rreg	Edukat.	aktive
1.	Episkopi	-	-	-	-	-
2.	Grafoskopi	-	-	-	-	-
3.	Mjete në kaseta	-	-	-	-	-
4.	Radio	-	-	-	-	-
5.	Kasetofon	5	5	-	-	-
6.	Magnetofon	-	-	-	-	-
7.	Gramafon	1	-	1	-	-
8.	Kino prozhektor 8mm	-	-	-	-	-
9.	Kino prozhektor 16mm	-	-	-	-	-
10.	Stacion lajmërues	-	-	-	-	-
11.	TV. marrës	4	4	-	-	-
12.	Video kamerë	1	1	-	-	-
13.	DVD-player	3	3	-	-	-
14.	Makinë shkrimi	2	2	-	-	-
15.	Kompjuter	4	4	-	-	-

Në marrëdhënie me pajisjen audiovizuale dhe të tjerat ndihmesa teknike nuk mundemi të jemi të kënaqur, pasi siç shihet prej pamjes tabelore këto ndihmesa nuk i plotësojnë nevojat e çerdhës.

4. Biblioteka

Dhomë apo hapësirë që do të shfrytëzohet për këtë nevojë nuk ka, por literatura profesionale e cila është në disponim ruhet në hapsirë të vecantë,dhe atë:

a) literaturë profesionale

b) literaturë për fëmijë

Prej literaturës profesionale që shërbehet kuadri edukues ka në dispozicion doracakë prej të gjitha lëmive edukato-arsimore të lejuara prej Ministrisë për punë dhe politikë sociale (MPPS).

Po ashtu në kohën e fundit i shfrytëzojmë edhe doracakët të lejuara nga Ministria për punë dhe politikë sociale.

Këtë vit shkollor do ti përdorim edhe doracakët Lojëra kreative për fëmijë prej 4-5 vjet dhe Lojëra kreative nga 5-6 vjet po ashtu dhe zilo zilo për Bon Ton.

Me literaturë për fëmijë dhe revista për fëmijë nuk disponohet me sasi të mjaftueshme por prapë se prapë në korniza të mundësive i kemi revistat elementare po ashtu edhe fletushkat me vizatime smeshko, rosica, dhe të ngjashme të lejuara nga MPPS.

Në kornizat e institucionit bëhen edhe përpjekje të mëdha për sigurimin e literaturës përkatëse me qëllim që të pasurohet fondi me literaturë profesionale por për shkak të kufizimit mundësitë financiare janë të kufizuara.

5. Numri i grupeve dhe numri i fëmijëve.

Llojet e grup edukuese	Struktura e grup edukuese	Numri i grupeve	Numri i fëm.mashkuj	Num i fëm. Femr	Gjithsej fëmijë
Dhoma fëmijëve org. Amë	Prej 12 muaj mbi	-	-	-	-
	12 muaj prej 18 muaj mbi 18 deri 2 vite	1	12	8	20
		-	-	-	-
	Gjithësej	1	12	8	20

- Prej gjithsej 20 fëmijë 2 janë të bashkësisë etnike shqiptare.

Llojet e grupeve edu.	Struktura e grup. edukues	Numri i grupeve	Numri i fëm meshkujve	Numri i Fëm.femra	Gjithësej Fëmijë
Çerdhe e f.- Organizata amë	Mbi 2 vj.der 3 vj.	1	17	13	30
	Mbi 3 vj.der 4 vj.	1	16	16	32
	Mbi 4 vj.der 5 vj.	1	15	14	29
	Mbi 5 vj.der 6 vj.	1	40	31	71
	Gjithsej	5	88	74	178

- Në objektin amë prej:

- **2-3 vjeç** prej gjithsej 28 fëmijë 3 janë të bashkësisë etnike shqiptare.
- **3-4 vjeç** prej gjithsej 32 fëmijëve 3 janë bashkësisë etnike shqiptare 1 prej bashkësisë etnike turke.
- **4-5 vjeç** prej gjithsej 32 fëmijëve 3 janë prej bashkësisë etnike shqiptare.
- **5-6 vjeç** prej gjithsej 69 fëmijëve 3 janë prej bashkësisë etnike shqiptare,4 prej bashkësisë etnike turka dhe 3 prej grupit etnik rom.

Llojet e grupeve edu.	Struktura e grup. edukues	Numri i grupeve	Numri i fëm meshkujve	Numri i Fëm.femra	Gjithsej Fëmijë
Njësia "Lulet"	Mbi 2 vj. deri 3 vj.	1	14	15	29
	Mbi 3 vj. deri 4 vj.	1	13	19	32
	Mbi 4 vj. deri 5 vj.	1	15	20	35
	Mbi 5 vj. deri 6 vj.	1	21	11	32
	Gjithsej:	4	63	65	128

Në njësin "Lulet" prej:

- **2-3 vjeç** gjithsej 29 fëmijë të gjith janë prej bashkësisë etnike maqedonase.
- **3-4 vjeç** gjithsej 32 fëmijë të gjith janë prej bashkësisë etnike maqedonase.
- **4-5** prej gjithsej 35 fëmijëve 3 janë prej bashkësisë etnike turke.
- **5-6** prej gjithsej 32 fëmijë 1 është prej bashkësisë etnike turke.

Njësia "Dallëndyshet"

Llojet e grup edukuese	Struktura e grup edukuese	Numri i grupeve	Numri i fëm. mashkuj	Num i fëm. Femr	Gjithsej fëmijë
Dhoma fëmijëve.	Prej 12 muaj mbi	-	-	-	-
	12 muaj prej 18 muaj mbi 18 deri 2 vite	1	11	9	20
		-	-	-	-
	Gjithësej	1	11	9	20

- Prej gjithsej 20 fëmijë 9 janë prej bashkësisë shqiptare.

Llojet e grupeve edu.	Struktura e grup. edukues	Numri i grupeve	Numri i fëm meshkujve	Numri i Fëm.femra	Gjithsej Fëmijë
Njësia "Dallendyshet"	Mbi 2 vj. deri 3 vj.	1	10	12	22
	Mbi 3 vj. deri 4 vj.	1	11	23	34
	Mbi 4 vj. deri 5 vj.	1	20	10	30
	Mbi 5 vj. deri 6 vj.	1	21	14	35
	Gjithsej:	4	62	59	121

- **2-3 vjeç** prej gjithsej 22 fëmijë 12 janë të bashkësisë etnike shqiptare, 3 janë prej bashkësisë etnike turke, 2 prej bashkësisë etnike rome.
- **3-4 vjeç** prej gjithsej 34 fëmijëve 25 janë bashkësisë etnike shqiptare, 8 prej bashkësisë etnike turke, 1 prej bashkësisë etnike rome.
- **4-5 vjeç** prej gjithsej 30 fëmijëve 18 janë prej bashkësisë etnike shqiptare, 10 prej bashkësisë etnike turke, 2 prej bashkësisë etnike rome.
- **5-6 vjeç** prej gjithsej 35 fëmijëve 20 janë prej bashkësisë etnike shqiptare, 12 prej bashkësisë etnike turka dhe 2 prej grupit etnik rom.

Gjithsej:		231	219	450
-----------	--	-----	-----	-----

Në IPKKF “ Ollga Miceska”Kërçovë përfundimisht me shtatorin janë të regjistruar 450 fëmijë, prej të cilëve:

- 307fëmijë janë nacionalitetit maqedonas.
- 100 fëmijë janë prej bashkësisë etnike shqiptare.
- 33 fëmijë janë prej bashkësisë etnike turke.
- 10 fëmijë janë të bashkësisë etnike rome.

ORGANIZIMI I JETËS DHE PUNËS NË QENDËR

1. Organizimi i jetës dhe punës në dhomat e fëmijëve

Dhomat e fëmijëve përfaqësojnë një kolektiv specifik me marrëdhënie ndërfëmimore me të rritur, dhe fëmijë me fëmijë që kanë vlera të posaçme dhe përparësi për zhvillimin e personit të gjithanshëm, duke u nisur prej qëllimeve të arsimimit dhe edukimit parashkollor.

a) Kujdesi dhe ushqimi i fëmijëve

Për tu kënaqur nevojat organike të fëmijëve nevojitet që të përcillet kujdesi dhe ushqimi. Me kujdesin dhe ushqimin e drejt kontribuohet në rritjen e drejt fizike dhe zhvillimin e fëmijës dhe zhvillimin shprehive elementare, për ushqim dhe mbajtjen e higjienës. Motra medicinale e cila edhe kujdeset është edhe një kusht kryesor dhe i drejt, dhe organizim i suksesshëm në kujdes. Ato momente duhet të jenë burim i përjetimeve të lumtura dhe të kënaqshme të fëmijës.

Gjatë ushqimit fëmija merr shprehi që të marri pjesë aktive për konsumimin e ushqimit, të ushqehet me lugë dhe më vonë edhe vetë të shërbehet.

Ushqimi i fëmijëve në atë moshë duhej t’u përgjigjen të gjitha standardeve dhe normativave dhe të njëjtët të kontribuojnë për zhvillimin e drejt të personit.

b) shëndeti dhe zhvillimi fizik i fëmijëve

Treguesi kryesor për vlerësimin e zhvillimit fizik të fëmijës është pesha fizike dhe lartësia. Rritja e peshës dhe lartësisë janë individuale, dhe për vlerësimin e zhvillimit të fëmijës (që pi gji) dhe fëmijës së vogël përherë duhej të shfrytëzohen të dy treguesit.

Brenga për shëndetin dhe zhvillimin fizik të fëmijës, përveç familjes ka edhe organizimi i fëmijëve dhe kujdesi në dhomat e tyre,si një formë në qendër për edukim dhe arsimim parashkollor. Zhvillimi i drejt do të arrihet me plan dhe punë të organizuar në qendrat parashkollore si kujdesi i drejt për ta, ushqimi i drejt, higjiena dhe i gjithë organizimi i jetës në çerdhe.

c) Aktivitetet edukues

Aktivitetet edukues te kjo moshë do të realizohen nëpërmes llojllojshmërisë simbolike, lojërat funksionale-didaktike, konstruktive, krijuese, lojërat lëvizëse, me të cilat pasurohej përvoja fëmijërore nëpërmes së cilave do të zhvillohen lëvizjet dhe të folurit e fëmijëve.

Lojërat dhe qëndrimi në ajër dhe përcjellja e fëmijëve do të përdoret për çdo ditë, si dhe aktivitetet e lojërave të fëmijës. Me qëndrim në ajër dhe lojërat te fëmijët zhvillohet organizimi fëmijëror dhe ruajtja dhe kujdesi i shëndetit të fëmijës.

2. Organizimi i jetës dhe puna në çerdhen e fëmijëve.

Në themel organizimi gjithëpërfshirës në jetën dhe punën në çerdhet e fëmijëve përcillet nëpërmes dy segmenteve bazë, dhe ato janë ushqimi dhe kujdesi për shëndetin dhe zhvillimi fizik i fëmijës, dhe organizimi dhe aktiviteti edukativo-arsimor.

Aktiviteti edukativo-arsimor në qendrën parashkollore e përfshin tërë punën me fëmijë gjatë ditës, për atë shkak atë e bënë komplekse dhe specifike. Aktiviteti edukativo-arsimor realizohet nëpërmes aktiviteteve llojlojshëm e lidhur me përditshmërinë dhe nevojat e fëmijës, si në lojëra, aktivitetet në punë dhe në mësim. Gjatë këtyre aktiviteteve duhet të mundësohet që fëmijët sa më tepër të adaptohen në rrethin e vet, të formojnë siguri, vetëbesim dhe socijabilizim.

Ato aktivitete janë të **lira, të kahëshme dhe jetike.**

Roli dhe dijenitë e **aktiviteteve të lira** përbëhen si në vijim: ti sigurohet liria e lojës, kahja dhe ndjekja e zhvillimit të fëmijës, nëpërmes atyre aktiviteteve si formë që fëmija të krijojë, të shoqërohet me fëmijë të tjerë, nëpërmes aktiviteteve të përbashkëta, së bashku të dalin në ajër të pastër dhe në vend të hapur. Organizohen sipas interesave dhe dëshirave të fëmijëve, a realizohen sipas orarit ditor, vendit dhe stinës së vitit. Këto aktivitete realizohen në vend të hapur. Për këto aktivitete sigurohen edhe kushte të veçanta, raftë përkatës për lojëra, mjete të nevojshme didaktike dhe lojëra, fletore me fotografi ose të ngjashme.

Aktivitetet e kahëzume do të kryhen çdo ditë në kohë të caktuar, përpara të planifikuar me përmbajtje nga veprimtaria edukativo-arsimore. Duke përgatitur përmbajtjen kohore duhet pasur kujdes që të mos ngarkohen fëmijët. Me këto aktivitete udhëheq personeli aktivo-përkujdesur. Edhe në këtë vit shkollor edukatorët do të përpunojnë plan global vjetor ku do të jenë të futur temat edukativo-arsimore, veprimtaria dhe koha e realizimit do jetë gjatë gjithë vitit shkollor.

Aktivitetet jetësore do të përfaqësojnë format e kënaqësive të nevojave fëmijërore, nevojat për ushqim, për pushim, mbajtja e higjienës dhe të njëjta. Lidhshmëria e aktiviteteve është e përditshmëri e jetës së fëmijës për kohën e qëndrimit të tij, po ashtu ka rol kryesor arritjen e veprimtarisë edukativo-arsimore. Nëpërmes këtyre aktiviteteve ato kënaqen ashtu siç u tha më lart, nevojat fëmijërore për ushqim, pushim, qëndrim në ajër, mundësojnë formimin dhe forcimin e shprehive kulturo-higjienike të fëmijëve dhe të ngjashme.

a) Plani javor dhe vjetor në kaheve aktiviteteve sipas veprimtarisë edukativo-arsimore

Edukativo-arsimore njësitë	Numri i orëve të aktiviteteve sipas moshës së fëmijëve							
	Grupi i parë i vegël		Grupi dytë I vogël		Grupi i mesëm		vjetor	
	javor	vjetor	javor	vjetor	javor	vjetor	javor	vjetor
Edukata fiz-shënd.	1	34	1	35	1'5	54	1'5	57
Njohuri n. dhe sh.	1	34	1	35	1	36	2	76
Kul.e të folurit	1	34	1	35	1	36	2	76
Hyrje në matem.	-	-	0'5	15	1	36	1'5	57
Art figurativ	1	34	1	35	1'5	54	2	76
Muzikë	1	34	1	35	1	36	1	38
gjithsej	5	170	5,5	190	7	252	10	380

b. Punimi edukues i fëmijëve.

1. Qëllimet dhe detyrat. Qëllimet dhe detyrat e punës edukative të fëmijët parashkollor dalin prej qëllimit kryesor të njerëzve të punësuar, prej qëllimit të përgjithshëm të punës dhe edukimit politeknik në shoqërinë tonë të fëmijëve dhe prej specifikitetit të aktivitetit të punës së tyre. Qëllimi i punës edukative është të fëmijët që të vendojnë marrëdhënie pozitive sociale-emocionale për punën dhe të zhvillojnë shprehje dhe mendime për punët elementare.

Detyrat e punës edukative janë:

- të kontribuojë për të dhënë interes dhe sjellje pozitive për punën mjetet për jetën, lojërat dhe punën;
- të kontribuojë për të dhënë dijeni elementare praktike dhe shprehje për kryer punët dhe aktivitete të caktuara në mënyrë të pa varur;
- njohuri për punët e njerëzve drejtpërdrejtë në mjediset shoqërore;
- të zgjojë interes për lëndët teknike lëndët dhe lodrat dhe të formojë dijeni pune për konstruktiv me material të formuar dhe të pa formuar;
- të formojë shprehje për rend, rregullsi dhe pavarësi, i zellshëm, qëndrueshmëri, përgjegjshmëri, iniciativë dhe të ngjashme., dhe
- ti përgatisë fëmijët për punë dhe angazhime në shkollë.

2. Forma, përmbajtje dhe aktivitete. Format dhe përmbajtjet e punës edukative do të formohen në pajtueshmëri me programin e veprimtarisë edukativo-arsimore. Aktivitete dhe forma të tilla mund të jenë, punë aktiviteti për vetëshërbim të drejtpërdrejtë në mesin shoqëror, aktivitete në natyrë dhe në rreth dhe të tjerë.

c) Edukimi ekologjik

1. Qëllimet dhe detyrat, format, përmbajtja dhe aktivitetet. Qëllimet dhe detyrat e këtij edukimi të fëmijët të krijojnë dashuri dhe shprehje për ambient të pastër dhe të shëndoshë, për të mbajtur pastërti në sipërfaqet e oborreve dhe të hortikulturës.

- të realizojnë aksione në brendi të çerdhes, për edhe jashtë saj për një mes të pastër, si dhe qytet të pastër, dhe me të kyçen në aksion. “ Jave e higjienës”. Pranvera është koha më e mirë e vitit, kur edhe fillon një jetë e re, ku çdo njëri duhet të kuptojë vetvetes për luftën kundër shkatërrimit të natyrës. Përmbajtja dhe aktivitetet do të dalin prej qëllimeve dhe detyrave prej edukimit ekologjik. Te fëmijët të krijojnë shprehje pune për të mbjellë fidanë të reja, lule pastaj edhe të kujdesen për ta.;

- të fëmijët të krijojnë dashuri për hortikulturën e gjelbër e cila na rrethon rreth çerdhes, më shpesh të realizohen në ajër të pastër, të ujiten lulet në oborr dhe tu sqarohet për nevojën e ujitjes.

- fëmijëve tu sqarohet që ta duan natyrën ,dhe pse duhet bërë ajo, a te do ta vërejnë duke u shëtitur nëpër natyrë. Muaji maj e muaji i ekologjisë dhe atëherë me fëmijët bëhen shëtitje dhe njëherë simbolikisht të kyçen në pastrimin e sipërfaqeve të oborrit, brenda në çerdhe, ta rregullojnë oborrin, parkun dhe ashtu me radhë. Zgjidhet tema “ Pranvera”, bëhen më shumë shëtitje dhe vëzhgojnë: vizita të kopshteve të lulëzuar dhe gjelbëruar ku do të mundej të kuptojnë dhe ndiejnë zgjimin e natyrës, fëmijët njihen edhe me insektet, zërat dhe aromat e pranverës, punën e njerëzve në natyrë dhe të ngjashme.

PLANIFIKIMI DHE PËRGATITJA E PUNËS EDUKATIVE – ARSIMORE

1. Përkujdesja, edukata-arsimore dhe kuadri profesional në qendër në pajtim me programin për veprimtarinë edukativo-arsimore në edukimin parashkollor dhe arsimimin, do të përpunojë plan global vjetor për të gjitha veprimtaritë edukative-arsimore. Për këtë vit shkollor 2022/2023 a me qëllim për realizimin sa më të mirë të programit të veprimtarisë edukativo-arsimore në qendrën tonë parashkollore,do të përgatis plan global vjetor për të gjitha veprimtaritë edukativo-arsimore, dhe atë:

- Personeli përkujdesës do të përgatisë programin për këshillin e përgëdhelseve;
- personeli edukues do të përgatis programin e për këshillin e edukatoreve;
- pedagogu do të përgatis programin vjetor për realizimin e detyrave të parashtruara sipas muajve.

2. Personeli përkujdesës i kuadrit edukativo-arsimor do të bëjë përgatitjen-planin ditor për aktivitetet e lira që u dedikohen fëmijëve. Në qendrën tonë planifikimi është tematik dhe në te nuk e ka ndarjen e më pashme tematike të ditës për aktivitetet e lira, lojëra dhe shëtitje, por të gjitha ata janë të gërshetuara dhe realizohen varësisht nga nevojat dhe interesat e fëmijëve, kurse të gjithë prej anës së vet të lidhura me temat e dhëna. Pikërisht gjatë ditës ose për realizimin e njëres nga përmbajtja tematike të përfaqësuara me të gjitha veprimtaritë edukativo-arsimore nëpër kate. Çdo edukator për grupin e vet përpunon plan vjetor për punën edukativo-arsimore. Ajo përmban detyrat zhvillimore në të cilat duhet të punohet për grupin dhe vitin shkollor, zgjedhja e temave nëpërmes detyrave të parapara që do të realizohen.

3. Plani dhe programi për realizimin të formave jashtinstitucionale të punës me fëmijët në qendër nuk ka.

4. Plan për punën e grupit që e realizon programi “Hap pas hapi” prej fondacionit Soros.

Me fillimin e realizimit të projektit grupor, kujdeset komplet që të arrihen rezultatet në punën e vet. Përcillen të gjitha komponentët fillestare të programit, disa përmbajtje përkatëse të cilat përgjigjen në zhvillimin e fëmijës, duke kyçur familjen dhe prindërit, duke respektuar individualitetin e fëmijës dhe mundësitë që fëmijët të bëjnë zgjidhjen e rafteve dhe aktivitetet e argëtimit. Së bashku marrin pjesë aktivitetet e lira të mëngjesit nëpër raftet, në të njëjtën kohë bëjnë konsultime për realizimin aktivitetëve të planifikuara për ditën në vijim, pjesëmarrje e prindërve(nëse i ka).

Grupi dhe prindërit prezent në dhomat e zbavitjes së bashku planifikojnë ditën e ardhshme dhe plani i përgatitur vendohet përpara dhomave të zbavitje. Po ashtu regjistrohen prindërit prezent, u shprehen në vend falënderime për atë kushtim. Pas orës 12:30 edukatorët evidentojnë dhe evoluojnë punën e ditës së kaluar.

Plani i temës, dimensionit vendor dhe kohor përgatiten së bashku dhe skemat i bëjnë grupet e argëtimit, treguesit e skemave të temave vendohen në tabelën e shpalljeve në hollin në vendin që për të është caktuar.

Edukatoret janë në pauzë prej orës 10:15 deri në ora 10:45 dhe pas pauzës bëhen përgatitje të përbashkëta për drekë (larja e duarve, servili). Pauza për përkujdesjet është prej orës 12:00 deri orës 12:30. Pas kafjallit fëmijët kthehen në dhomat për zbavitje ose në oborrin e çerdhes dhe fillojnë me aktivitetet e lira dhe të gjithë i rregullojnë materialet në dhomën për argëtim.

5. Kujdes i veçantë do ti dedikohet angazhimit dhe kujdesit të kuadrit edukativo-arsimor të qendrës në fushën për përparimin e veprimtarisë,nëpërmes të zbatimit të formave dhe metodave të reja të punës, përgatitjen e mjeteve punues-lodruës dhe të tjera.

Duke u nisur nga nevojat për planin tematik, ose periudhën tematike në përmbajtjen e planit edukativo-arsimor, pastaj ndjekjen e tij dhe observimin në pajtueshmëri me dëshirat e tyre. Gjatë planifikimit ditor për temën e ditës për realizimin me sukses dhe për arritjen e zhvillimit të detyrave të parashtruara është e domosdoshme të mendohet mesi fizik në të cilin fëmija do të luaj dhe mësojë. Po ashtu me rëndësi është zgjidhje e përmbajtjes në të cilën masë do të dozohet, ajo do të thotë të mos jetë shumë i lehtë, por edhe shumë i rëndë për përvetësim.

Sa i përket kohës nuk kërkohet distancë e rreptë kohore dhe duhej të ketë kombinim të punës frontale, që do të thotë kohë grupe, puna paralele në raftë të grupeve më të vogla dhe punës individuale.

Në shikim të metodave që shfrytëzohen sot në punën edukativo-arsimore, vlen me to të aktivizohen të gjithë fëmijët dhe zvogëlojmë pjesëmarrjet e tyre pasive, fëmijëve t'u japim më shumë zgjidhje, ta respektojmë principet dhe individualitetin dhe ta kultivojmë punën grupe duke përfshirë edhe persona të tjerë të interesuar.

Fëmijët i nxisim në mëvetësim dha pavarësi. Që do të sjellë deri te roli i edukatorit gjatë lojërave dhe aktiviteteve, pjesëmarrje e tij nuk është përherë e domosdoshme. Ndonjëherë roli i tij është më kompleks, a ndonjëherë do të ketë rol drejtues-interaktiv.

Për realizim të suksesshëm të lojërave dhe aktiviteteve lodruese me rëndësi janë materialet dhe mjetet për lojëra të jenë tërheqës për fëmijët, të jenë të venduar në vende të caktuar që do të tërheqin vëmendjen, të jenë sa më të llojlojshëm që të kënaqin në më shumë aspekte në zhvillimin e fëmijës, dhe me të arrihen detyrat të parapara për atë ditë. Këto aktivitete lodrues janë vetëm pjesë e asaj për çka mundet të realizohen në punën edukativo-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore.

VEPRIMTARIJA PEDAGOGJIKO – PROFESIONALE NË QENDËR

1. Mbrojtja shëndetësore e fëmijëve

a) Nevoja dhe kuptimi i këtij aktiviteti në qendër është me domethënie primare. Mbrojtja shëndetësore e fëmijëve në qendër është pjesë përbërëse në bazën e mbrojtjes shëndetësore. Me përfshirjen e fëmijëve në jetën kolektive, futet një problem serioz shëndetësor i cili në mënyrë adekuate duhet të zgjidhet për shkak se për mbrojtjen dhe përparimin e shëndetit është një prej detyrave parësore, dhe njëherë njëri prej parakushteve për suksesin tërësorë në punën e këtyre institucioneve. Në këtë moshë fëmijët janë të ndjeshëm veçanërisht në infeksione (të pa pjekur në mbrojtjen mekanike të imunitetit) lehtë mund të lëndohen, jo të pjekur në motorikë dhe lehtë mund të lëndohen, mangësi në përvojë dhe për atë fëmijë është e nevojshme ushqim i duhur, dhe mes i shëndosh social motiv.

b) Qëllimi dhe detyra e qendrës të fëmijët në këtë moshë që të rritet i shëndosh dhe personalitet i drejt psikofizik dhe social, dhe eliminimin e ndikimeve të dëmshëm për shëndetin e tyre.

- të krijohen kushte për të ruajt dhe përparuar shëndetin e fëmijës;
- të merren me kohë masa hijeno-epidemiologjike dhe profilaktike;
- të organizohet qëndrim i shëndosh dhe ushqim i plotë;
- të bëhen kontrollime sistematike të gjendjes shëndetësore të fëmijëve dhe të ndiqet.
- të ndiqet gjendja e dhëmbëve të fëmijët;
- të realizohet shëndetësore-edukative dhe arsimim shëndetësor të prindërve;

- të udhëhiqet dokumentacion shëndetësor për zhvillimin psikofizik dhe ngjashëm.

c) Format dhe përmbajtjet e aktiviteteve për arritjen e mbrojtjes shëndetësore të fëmijët mundet të absolutojnë nëpërmes:

1. Mbikëqyrës sanitar – higjenik të objekti që do të realizohen me;

- higjiena nëpër dhoma, higjiena dhe kushtet për punë, nëpër dhoma ku qëndrojnë fëmijët,

- kontroll nëpër dhoma ku ruhen, përgatitet dhe distribuohet ushqim,

- higjiena në dhomat e fëmijëve dhe mënjanimi i hedhurinave.

2. Kontrollim dhe mbikëqyrje të ushqimit:

- procesi për ruajtjen e ushqimit,

- dhënia e ushqimit,

- ndihma profesionale në lidhje me ushqim të shëndosh.

3. Ndjekja e rritjes dhe zhvillimi i fëmijëve:

- vizita sistematike,

- kontroll stomatologjik

4. Tejkalimi i problemeve me shputat e rrafshëta të fëmijët:

- edukimi i një numri të caktuar të edukatorëve, si rregull që do të realizojnë ushtrimet me fëmijët, me qëllim që të arrihet rritja dhe zhvillimi i drejtë të fëmijët, të zvogëlohet numri i fëmijëve me shputa të rrafshëta, si formimi i shprehive të ushtrimeve me fëmijët,

- edukimi i prindërve, që në kohën e lirë të ushtrojnë me fëmijët e tyre

d) Bartësit e mbrojtjes shëndetësore janë mjekët dhe persona medicinës. Pasi që qendra nuk është në gjendje të sigurojë mjek me marrëdhënie pune të përhershme, për mbrojtjen shëndetësore të fëmijëve kujdeset motra medicinale, e cila si punëtore e pavarur kyçet në të gjitha aksionet.

- tirazhe të fëmijëve gjatë pranimit në qendër (çdo dite)

- kontrollim të ushqimit

- vëzhgim të fëmijëve me qëllim që të zbulojë të gjitha ndryshimet në gjendjen e tyre shëndetësore,

- kontrollim të higjienës,

- mbajtjen e dokumentacionit shëndetësor, evidencën dhe lajmërimin,

- bashkëpunim me qendrën medicinale, shërbimet sanitare dhe shërbime tjera të lidhura me këtë problematikë dhe me Entin për përparim të amvisërisë.

2. Veprimtaritë kulturore dhe publike.

a) Qëllimi dhe detyra prej fushës të veprimtarisë të kulturës publike është që të kontribuojë që sa më plotësisht të realizohen detyrat në shoqërinë organizative të arsimimit para shkollor, a veçanërisht në rezultatet e edukimin dhe arsimimit dhe zhvillimi i pasurimit të jetës sociale dhe kulturore në meset sociale në të cilën punon qendra parashkollore.

Qëllimet dhe detyra e veprimtarisë publike dhe kulturore janë:

- që të afirmohet çerdhja në mesin shoqëror, por edhe si qendër kulturore arsimore dhe si qendër me interes më të gjer shoqëror dhe veçanërisht domethënie për të krijuar kujdes shoqëror për fëmijët;

- që tu mundësohet fëmijëve gradualisht që të njihen me bazat themelore të jetës në shoqëri, ndodhitë në rreth, si dhe të njoftohen me institucionet kulturor dhe shoqëror;

-të sigurohet pjesëmarrje aktive e edukatorëve dhe përgëdhelseve dhe punëtorëve të tjerë prej qendrës parashkollore për jetën shoqërore të rrethit;

-të organizohet bashkëpunim maksimal me prindërit e fëmijëve me qëllim që të sigurohet i vetmi kujdes për zhvillimin e fëmijëve;

-prindërve tu mundësohet kyçje aktive në zgjidhjen e problemeve në qendër, për të krijuar kushte më të volitshëm për realizimin e veprimtarisë;

-qendra të zhvillojë vetëdije shoqërore të rriturit dhe të ndikojë për interesim dhe të ndikojë mbi të formojë nevojë për organizimin shoqëror në edukimin dhe arsimimin parashkollor.

b) Si format dhe përmbajtja prej kësaj problematike aksenti do të jetë mbi bashkëpunimin me prindërit që zen vend të posaçëm dhe ajo do të realizohet për tu përputhur ndikimi i institucionit dhe familjes dhe në atë mënyrë të ngrihet kualiteti i organizimit të shoqërisë në edukimin dhe arsimimin parashkollor. Bashkëpunimi i prindërve kryesisht realizohet nëpërmes formave në vijim:

- Bisedat gjatë pranimit ose përcjelljes së fëmijëve, që prindërit të jenë të informuar për të kërjt atë që ka qenë me rëndësi gjatë ditës të qëndrimit së fëmijës në grupin apo në institucion;

- Konsultimet individuale që mundësojnë të dy faktorët edukues ti vërtetojnë shënimet e veta dhe propozimet ose ti dinë risitë e të arriturave të zhvillimit të fëmijës;

- Vizitat shtëpiake si forma të veçanta të bashkëpunimit kanë vlera të veçanta në zhvillimin e fëmijës. Me të kryhet dijenia për atë ku dhe si, që do të thotë se në çfarë kushtesh familjare dhe shoqërore jeton fëmija;

- Bisedat në grupe, përkatësisht biseda me grup prindërisht në tema të njëjta të lidhura me një problem të caktuar i cili është i përbashkët për të cilin mblidhen mendime dhe sugjerime për zgjidhjen e problemit nëse atë e ka;

- Mbledhjet prindërore janë forma të veçanta për bashkëpunim në qendër të fëmijëve të moshës parashkollore, si edhe takimet e përgjithshme prindërore, me ato prindër ose shfrytëzuesit e shërbimeve të veçanta, në grupe të moshës së caktuar;

- Ekspozitat janë forma natyrore të bashkëpunimit ku prindërit informohen. Ato realizohen në një vend, demonstrohen materiale me interes të caktuar për prindërit si dhe krijime arti të fëmijëve, punimet e fëmijëve me materiale natyrore, fotografi të jetës dhe punës të fëmijëve dhe ngjashëm;

- Shfaqet dhe manifestimet ku marrin pjesë fëmijët kanë vend me vlerë në bashkëpunim në mes prindërve dhe çerdhes. Këto shfaqje dhe manifestime që organizohen duhet të jenë pjesë përbërëse në përmbajtjet që realizohen për çdo ditë në veprimtarin edukativo-arsimore;

- Në kohën më të re me kyçje të projektit “Hap pas hapi” familja ka rol qendror për realizimin e programit në tërësi. Për atë qëllim është formuar komiteti këshillëdhënës i prindërve i cili drejtpërdrejtë lidhet në realizimin e programit

3. Përcjellja dhe përparimi i përndjekjes së veprimtarisë edukativo-arsimore në qendër.

- **Qëllimi bazë** në përndjekjen edukativo-arsimore është krijimi i përshtatshëm në mesin edukativ në të cilin fëmija në mënyrë të drejtpërsëdrejti do të përfitojë përvojë, a gradualisht me sistem të organizuar të metodave dhe përmbajtjeve do të përgatitet për dijeninë dhe zbulime të vetvetes dhe rrethit të vet, a qëllimi kryesor i veprimtarisë

edukativo-arsimore është që ti ruaj , përkrahi, stimulojë, zhvillojë dhe fisnikërojë aktivitetet spontane të fëmijës, të respektojë individualitetin e vet të zbulimit, inkuadrimit dhe ndryshimit e botës rreth vetvetes.

4. Integrimi ekologjik dhe edukimi në sistemin e arsimit maqedonas.

Kualiteti në procesin arsimor mundet të definohet si arsim i përshtatur për nevojat e të tashmes dhe të ardhshmes për nevojat e çdo fëmije dhe grupeve shoqërore pavarësisht nga rrethanat dhe mundësitë e mëtutjeshme. Kuptimi i kualitetit i përfshin edhe zhvillimet e mundësive të çdo pjesëmarrësi në procesin arsimor. Rruga e zhvillimit të individit shkon nëpërmes zhvillimit të nevojave të tij, interesave, mundësive, synimeve, pritjeve dhe aftësive.

Në kontekst të nevojave dhe mundësive për arsimimit kualitativ, u bë hyrje e projektit: eko-çerdhja.

- Qëllimet bazë:

1. Dijenitë e përfituara në temën jeta e mjedisit të zbatohet në praktikë pasi nuk kemi planetë rezervë për jetesë.

2. Të rritet vetëdija te fëmijët, edukatorët, përgdhelset, personeli teknik, prindërit dhe të gjithë të tjerët të cilët janë të kyçur direkt apo indirekt në programin në temën jeta e mjedisit dhe me te do të mundësohet dijenia teorike të zbatohet në jetën e përditshme.

3. Me këtë program fëmijët do të përfitojnë rol aktiv dhe përgjegjësi që do ta praktikojnë në çerdhe në shtëpinë e vet dhe në njësitë lokale dhe më gjerë.

Krejt kjo do të arrihej me zbatimin e katër eko standardeve: kursimi i energjisë, kursimi i ujit, mirëmbajtja e ndërtesës dhe mesit shëndetësor në çerdhe dhe rregullimi i oborrit ekologjik.

I. EKO-STANDARDI: KURSIMI I ENERGJISË

Polisa: Shfrytëzimi racional i energjisë elektrike dhe energjisë për ngrohje në çerdhe.

Qëllimi: Zvogëlimi i harxhimit të energjisë elektrike dhe asaj për ngrohje për 10% në krahasim me vitin e kaluar.

Pika e aksionit	Tema	Lëmi edukative arsimore	Grupi madhore	Koha e realizimit
Theksimi i udhëzimit për përdorimin racional të energjisë elektrike dhe të ngrohjes	Si ta kursejmë dritën dhe ngrohjen	“ Rrethi im “ -natyra dhe shoqëria -edukimi i artit figurativ -gjuhë maqedonase	Prej 5-6 vjeç	Tetor janar
Theksimi i udhëzimit për përdorimin racional të energjisë elektrike dhe të ngrohjes	Si ta kursejmë ngrohjen dhe përdorimin e dritës	“ Rrethi im “ -natyra dhe shoqëria -edukimi i artit figurativ -gjuhë maqedonase	Prej 4-5 vjeç	Tetor janar
Theksimi i udhëzimit për përdorimin racional të energjisë elektrike dhe të ngrohjes	Si ta kursejmë ngrohjen dhe përdorimin e dritës	“ Rrethi im “ -natyra dhe shoqëria -edukimi i artit figurativ	Prej 3-4 vjeç	Tetor janar
Theksimi i udhëzimit për përdorimin racional	Si ta kursejmë ngrohjen dhe përdorimin e	Arsimimi në gjuhën maqedonase	Prej 2-3 vjeç	Tetor janar

të energjisë elektrike dhe të ngrohjes	dritës			
--	--------	--	--	--

II EKO- STANDARD: KURSIMI I UJIT

Polisa: Shfrytëzimi racional i ujit te ndërtesa dhe oborri i çerdhes.

Qëllimi: Zvogëlimi i harxhimit të ujit për 10% në krahasim me vitin e kaluar.

Pikat e aksionit	Tema	Lëmi edukativo-arsimor	Grupi madhor	Koha e realizimit
Theksim në udhëzimin për shfrytëzimin racional të ujit	Rëndësia e ujit për të gjitha krijesat e gjalla	-Natyra dhe shoqëria -gjuha -arti figurativ	Prej 5-6 vjeç	Shtator maj
Theksim në udhëzimin për shfrytëzimin racional të ujit	Rëndësia e ujit për të gjitha krijesat e gjalla	-Natyra dhe shoqëria -gjuha -arti figurativ	Prej 4-5 vjeç	Shtator maj
Theksim në udhëzimin për shfrytëzimin racional të ujit	Rëndësia e ujit për të gjitha krijesat e gjalla	-gjuha -arti figurativ	Prej 3-4 vjeç	Shtator maj
Përdorimi i drejtë i ujit të pastër	Pe duhet ta ruajmë dhe kursejmë ujin	-gjuha	Prej 2-3 vjeç	maj

III EKO-STANDARD: MIRËMBAJTJA E NDËRTESES DHE MJEDISIT TË SHËNDOSH NË ÇERDHE

POLISA: Qëndrimi dhe puna në mes të pastër dhe të shëndosh.

Qëllimi: Krijimi i kushteve të shëndosha për qëndrim dhe punë në çerdhe.

Pikat e aksionit	Tema	Lëmi edukativo-arsimor	Grupi madhor	Koha e realizimit
Ngjyrosja e mureve me përdorim të eko ngjyrave të quajtura IOS	Ngjyrat gazmore e zbukurojnë çerdhen time	-Natyra dhe shoqëria -art edukativ -edukatë muzikore -gjuhë	Prei 5-6 vjeç	Shtator dhjetor Maj
Ngjyrosja e mureve me përdorim të eko ngjyrave të quajtura IOS	Ngjyrat gazmore e zbukurojnë çerdhen time	-Natyra dhe shoqëria -art edukativ -edukatë muzikore -gjuhë	Prej 4-5 vjeç	Shtator dhjetor Maj
Ngjyrosja e mureve me përdorim të eko ngjyrave të quajtura IOS	Emërimi i ngjyrave	-gjuhë -edukatë muzikore -art edukativ	Prej 3-4 vjeç	Shtator Dhjetor
Ngjyrosja e mureve me përdorim të eko ngjyrave të quajtura IOS	Emërimi i ngjyrave	-Gjuhë -edukatë muzikor	Prej 2-3 vjeç	dhjetor

IV EKO-STANDARD: OBORR I RREGULLUAR DHE EKOLOGJIK

Polisa: Oborr i rregulluar dhe funksional i cili është në përputhje me nevojat dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Qëllimi: Oborr i rregulluar dhe funksional me të gjitha parametrat ekologjik në mënyrë që maksimalisht do të përdoret për të gjithë që do të qëndrojnë në çerdhe.

Pika e aksionit	Tema	Lëmi edukativo-arsimor	Grupi madhor	Koha e realizimit
Vërja dhe përcaktimi i koshave për bërlllok organik për letër dhe plastikë	Prej nga vinë plehrat dhe ku shkojnë	-Natyra dhe shoqëria -gjuha -matematika	Prej 5-6 vjeç	Tetor Mars Prill maj
Vërja dhe përcaktimi i koshave për bërlllok organik për letër dhe plastikë	Prej nga vinë plehrat dhe ku shkojnë	-Natyra dhe shoqëria -gjuha -matematika	Prej 4-5 vjeç	Tetor Mars Prill maj
Vërja dhe përcaktimi i koshave për bërlllok organik për letër dhe plastikë	Prej nga vinë plehrat dhe ku shkojnë	-Natyra dhe shoqëria -gjuha Art edukativ	Prej 3-4 vjeç	Tetor Prill Maj
Vërja dhe përcaktimi i koshave për bërlllok organik për letër dhe plastikë		-gjuhë -edukatë muzikore	Prej2-3 vjeç	Prill Maj

-Planifikimi dhe organizimi i veprimtarisë përbëhet prej disa programeve:

1. Plani dhe programi i këshillit profesional i qendrës që e përbëjnë punëtorë profesional në të cilën përbërje për rreth drejtorit hynë pedagogu, motra medicinale dhe bashkëpunëtor ndihmës profesional. Këshilli profesional punon në seanca,që mbahen së paku njëherë në muaj,me ta udhëheq drejtori i qendrës. Si në të kaluarën edhe këtë vit përkryerja e kuadrit profesional do të jetë një nga detyrat më me prioritet i qendrës. Ajo do të realizohet në mundësitë e kornizave financiare të qendrës por edhe jashtë saj. Në qendër si formë e përkryerjes të kuadrit profesional do të shfrytëzohen aktivitetet e kaheve dhe të lira, referate, ligjërata, ndjekja e literaturës pedagogjike si dhe revistave për fëmijë. Jashtë qendrës përkryerja profesionale do të realizohet nëpërmes vizitave, seminareve, kurseve dhe vizitave të qendrave tjera parashkollore;

2. Plani dhe programi i këshillit të edukatorëve do të përbëjë formulimin e qëllimeve dhe detyrave të edukimit dhe arsimimit, të zhvillimit të formave dhe principeve punë që kontribuojnë për edukim dhe arsimim të gjithanshëm të fëmijëve, për zhvillimin dhe përparimin për kushtet e qëndrimit zhvillimit të tyre psikofizik, për përpunimin e programit të punës edukativo-arsimore, do të punojë për planin për përkryerjen profesionale të edukatorëve,do të realizojë bashkëpunimin me prindërit, qendrat parashkollore dhe të tjera. Këshilli i edukatorëve do të mbahet së paku njëherë në muaj dhe sipas nevojës edhe më shpesh.

Aktivitetet vijuese të këshillit të edukatoreve

Aktivitetet e tanishme të arsimtarëve në kopsht, përkatësisht përgjegjësitë e tyre si staf arsimor profesional , të specifikuar në sistemimin e detyrave të punës, janë këto:

- propozon planet e veta, mbi bazën e të cilave përgatitet programi vjetor i punës;
- përgatit përgatitjet vjetore, afatmesme dhe ditore për punë;
- përgatitet rregullisht për punën e saj dhe kujdeset për realizimin e detyrave;
- kryen punën arsimore në grup sipas programit të punës;

- rregullisht organizon aktivitete të synuara dhe veprimtari në lidhje me jetën e përditshme;
- përgatit mjete vizuale dhe materiale për punë të menjëhershme;
- mban rregullisht evidencë dhe administrimin për grupin në formë elektronike dhe të shkruar;
- kujdeset për pamjen estetike dhe higjenën e dhomës së grupit të saj;
- bashkëpunon rregullisht me prindërit, organizon takime dhe konsultime individuale dhe në grupe.

Planet zhvillimore

Edukatoret punën e tyre e planifikuan para fillimit të vitit shkollor - përmbajtje dhe aktivitete të mundshme, të cilat gjatë zbatimit të tyre do të udhëzohen nga Programi për mësimin dhe zhvillimin e hershëm, me qëllim të arritjes së standardeve për grupmoshën e përshtatshme.

Aktiviteti arsimor ishte planifikuar dhe do të zbatohet duke realizuar:

➤ **Tema:**

Muaji i realizimit	Tema	Grupi arsimor
Shtator	-Kopshti i fëmijëve është si një përrallë, kopshti është nëna jonë e dytë -Atdheu im	Të gjitha grupet (4-5 dhe 5-6)
Tetor	-Bukuritë e vjeshtës	Të gjitha grupet
Nëntor	-I duam kafshët	Të gjitha grupet
Dhjetor	-Dimri, dimri -Duart e mia të zellshme	Të gjitha grupet
Janar	-Vita vita vitamina janë të mira për shëndetin	Të gjitha grupet
Shkurt	-Si sëmuremi si shëndoshemi	Të gjitha grupet
Mart	-Pranvera lulëzoi -Dielli është burim i jetës	Të gjitha grupet
Prill	-Çka na rit? -Si ritem?	Të gjitha grupet
Maj Qershor	-Udhëtojmë udhëtojmë	Të gjitha grupet
Korrik	-Aktivitete verore	Të gjitha grupet
Gusht	-Lojëra verore	Të gjitha grupet
Gjatë gjithë vitit	-matematika nëpërmjet lojës	Të gjitha grupet

Udhëzime për planifikimin e aktiviteteve nga Programi i mësimi të hershëm dhe zhvillimit:

- "Lojëra tradicionale në institucione"
- "Aktivitete sportive dhe sporti"
- "Fitimi i shprehive të shëndetshme të jetesës dhe sjelljes së sigurt"

Projektet:

- "Qyteti nëpër sytë e fëmijëve"
- "Bon ton për fëmijë"
- "Nga fëmija tek fëmija"
- "Riciklimi me imagjinatë"
- "Vlerat familjare dhe familja"
- "Higjiena ime është shprehia im"

Aktivi I edukatoreve në programin e tyre gjithashtu përshkruanin aktivitetet, të cilat i referohen:

- Aktivitete publike dhe kulturore
- Bashkëpunim me prindërit
- Zhvillim profesional
- Bashkëpunim me mjedisin më të gjerë

3. Plani dhe programi i këshillit të përkujdesëseve do ti përmbajë qëllimet dhe detyrat të lidhura për përkujdesjen e aktiviteteve të fëmijëve, përkujdesjen e tyre, higjienën, ushqimin dhe veçanërisht shëndetin e tyre në kontekstin e zhvillimit psikofizik. Si dhe trupat e tjerë dhe këshilli i përgdhelseve do të mbahet së paku njëherë muaj.

Aktivitetet vijuese të këshillit të përkujdesëseve

- promovimi dhe intensifikimi i veprimtarisë edukative-përkujdesëse;
 - shërbim ditor nga Programin për mësimin dhe zhvillimin e hershëm, si dhe shërbim më të pavarur me të;
 - përdorimi i rregullt i literaturës profesionale që mbulon problemet e fëmijëve të moshës së duhur, si dhe përdorimin e tyre në punën e tyre.
 - planifikimi i aktiviteteve të lojërave me fëmijë nga mosha e kopshtit;
 - promovimin dhe intensifikimin e punës edukative-përkujdesëse;
- Gjatë realizimit të aktiviteteve edukative-arsimore, ata do të punojnë në inkurajimin dhe zhvillimin e të gjitha fushave të personalitetit të fëmijës, dhe ata do të zbatojnë gjithçka që përmes:
- krijojnë aktivitete (në grupmoshën më të vogël ato do të kryhen individualishtë, ndërsa në grupet më të mëdha të çerdheve do të fillojnë të punojnë në grupe prej 2-3 fëmijëve);
 - të dëgjosh muzikë;
 - imitimi i tingujve;
 - gjimnastikë;
 - formimi i detyrave të dhëna (ngjitje, zbritje, kalim ...);
 - veprimtaritë e të folurit (përshkrimi i objekteve, situatave, fotove, etj.)

4. Plani dhe programi i pedagogut me përmbajtjen e vet është i drejtuar në zgjidhjen konkrete të detyrave edukativo-arsimore. Programi përgatitet për çdo vjet shkollor dhe në bazë të tij realizohen aktivitetet e tij operative, sipas muajve. Bënë regjistrimin e fëmijëve në çerdhe, dhe i formon grupet edukuese sipas moshës dhe sipas njësive punuese. Së bashku me drejtorin bënë orarin e personelit edukativo-përkëdhelës në grupe si dhe orarin e materialit të nevojshëm për punë. Organizon takimet me prindërit dhe takime me të gjithë prindërit, po ashtu edhe në grupe. I drejton në literaturë pedagogjike për fëmijë dhe përherë i koordinon punët në realizimin e sa më të suksesshëm të programit. E stimulon punën e komitetit prindëror për këshilla, ashtu që me angazhimin e prindërve do të mundësohet më tepër për realizimin e disa pjesëve të programit.

Plani zhvillimor i pedagogut

Si pedagog i institucionit për vitin akademik 2022/2023, përveç detyrave aktuale, kam vendosur si përparësi realizimin e aktiviteteve të tilla si:

- formimi elektronik të grupeve;
- dhënia e udhëzimeve, këshillave për mbajtjen elektronike të regjistrave dhe dokumentacionit pedagogjik;
- ofrimin e ndihmës profesionale për punën edukative të përkujdesëseve nga grupet foshnjë;
- organizimi dhe pjesëmarrja në zbatimin e aktiviteteve të hapura interne;
- dhënia e ideve, sugjerimeve për përmbajtjen, veçanërisht për projektet;
- Dorëzimi i rregullt i raporteve në MPPS për aktivitetet në kopshtin tonë sipas projekteve;
- inicimin dhe dhënien e një mendimi për përmbajtjen për festimin e Javës së Fëmijëve dhe ditëve të tjera të rëndësishme ndërkombëtare;
- organizimi i shfaqjeve teatrore për fëmijë;
- pjesëmarrje dhe dhënja e sugjerimeve për shpërndarjen e materialit profesional për stafin arsimor;
- pjesëmarrje dhe dhënja e sugjerimeve për shpërndarjen e lojërave për fëmijë dhe materialit didaktik;

5. Plan dhe programë e psikologut

Puna e psikologut përmban detyra dhe aktivitete me anë të të cilave kontribon ngritjen e nivelit të kullitetit të punës edukativo- arsimore në kopshtin e fëmijëve dhe në funksionin shoqëror të saj.

Në bashkëpunim me punëtorët e tjerë profesional psikologu merr pjesë në planifikimin, programimin, përcjelljen vlerësimin dhe përparimin e punës në kopsht.

Përmbajtjet kryesore të programit vjetor do të jenë:

Nr. rendor	Përmbajtja	Bashkëpunim
1	Përgatitja e programës për punën e vet-plani opreativ.	Drejtor, kolegium profesional

2	Pjesëmarrje në përgatitjen e planit vjetor të institucionit	Drejtor , grupe punuese
3	Pjesëmarrje në formimin e grupeve edukative	Grupe punuese, edukatore përgjegjëse
4	Pjesëmarrje në komisionin për pranim të fëmijëve	Drejtor, pedagog dhe antëarë të komisionit
5	Përcjellje e adaptimit dhe socializimit të fëmijëve	Edukatore dhe përkujdesëse
6	Punë instruktive psikologjike me kuadrin në planifikimin dhe realizimin e punës edukativo-arsimore	Punëtorë profesional, edukatore dhe përkujdesëse
7	Përcjellje të zhvillimit psiko-fizik të fëmijëve	Edukatore dhe përkujdesëse
8	Identifikim dhe punë këshillëdhënëse me fëmijë me nevoja të veçanta dhe pengesa në zhvillim	Edukatore dhe përkujdesëseEnti për shëndet mental, Enti për dëgjim dhe të folur
9	Bashkëpunim dhe konsultime edukative me prindërit për pyetjet dhe problemet në zhvillim dhe edukim të fëmijëve	Drejtor, prindër
10	Analizë dhe studim në bashkëpunim për përparim të teorisë dhe praktikës për zhvillim të fëmijëve	Institucione profesionale
11	Bashkëpunim me organizata shkencore dhe institucione profesionale	Fakulteti filozofik- psikologjik, dhe organizata të përafërta me veprimtarinë

Brenda kornizave të aktiviteteve programore të psikologut , vëmendje të veçantë do të përkushtohet formimit të bazave dhe specifikave të zhvillimit të fëmijëve, aplikimi dhe respektimi në praktikë

6. Plani dhe programi i drejtorit do të përmbahet në realizimin e aktiviteteve të shënuara në planin vjetor të qendrës. Si person përgjegjës në qendër duhet të jetë aktiv i kyçur në të gjitha segmentet e punës dhe po ashtu të koordinojë me realizimin e përcaktimeve programore për përcjelljen e tyre të suksesshme. Aktivisht duhet të jetë i kyçur në realizimin e projekteve të reja, qofshin ato nga edukim-arsimimi natyror dhe deri te problemet e llojllojshëm të përditshëm të cilët do të dalin nga vetë puna. Aktiviteti permanent do të jetë i siguar i punës dhe dhënien e mundësive për realizimin e bazës së veprimtarisë. Puna e drejtorit e më tepër është e drejtua nga realizimi i asaj që është lëshuar në periudhën e kaluar me qëllim që ajo të plotësohet, të përpunohet, të përkryhet, dhe të futen kualitete të reja në çdo segment të punës. Qëllimi i drejtorit është që qendra të funksionojë a me të realizojë bazën e vet të veprimtarisë, të afirmohet jashtë lokacionit të vet që po ashtu është pasqyrë e të gjithë personelit.

Fushat kryesore të veprimit të drejtorit për vitin arsimor 2022/23. do të jetë:

- planifikimi, organizimi dhe realizimi i kushteve themelore për funksionimin e kopshtit;
- organizimin dhe unifikimin e shërbimeve të përgjithshme në kopshtin e fëmijëve dhe menaxhimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve të përbashkëta;
- Përfaqësimi dhe prezentimi i kopshtit;
- Propozimi i Programit Vjetor dhe Raportit për punën e kopshtit;
- Paraqitja e raporti për operacionet materialo-financiare në kopshtin e fëmijëve;
- Angazhim profesional në funksion të udhëzimeve pedagogjike dhe angazhimit të drejtpërdrejtë për promovimin e punës edukative dhe të përkujdesjes;
- Ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve për krijimin e kushteve optimale për qëndrimin e fëmijëve në ambientet e kopshtit;
- Pjesëmarrje sipas detyrës zyrtare në punën e Bordit Drejtues;
- Realizim i vendimeve të Bordit Drejtues;
- Shfrytëzimi i duhur, racional dhe i qëllimshëm i fondeve të kopshtit;
- Përgjegjësi për funksionimin juridik të kopshtit për sa i përket akteve ligjore dhe financiare;
- Shpërndarja e punëtorëve në vend të përshtatshëm;
- Kujdes i përhershëm për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin aktual të objekteve të institucionit;
- Vendosjen e marrëdhënieve themelore të bashkëpunimit me prindërit;
- Pjesëmarrje sipas detyrës zyrtare në Këshillin e Prindërve;
- Pjesëmarrje në komision për përpilimin e listës së ushqimeve për fëmijë dhe në lidhje me atë angazhim të drejtpërdrejtë për përmirësimin e cilësisë dhe shumëllojshmërisë së ushqimit;
- Ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve për krijimin e kushteve për realizimin e pandërprerë të kujdesit shëndetësor parandalues në ambientet e kopshtit;
- Marrjen e masave për zhvillimin e përhershëm profesional të stafit edukativ dhe arsimor në kopshtin e fëmijëve;
- Vendosjen e bashkëpunimit me vetëqeverisjen lokale - Komunën e Kërçovës, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, si dhe me institucione të tjera përkatëse;
- Realizimin e aktiviteteve tjera të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve dhe statutin e kopshtit.

PËRKRYERJA PROFESIONALE E PËRKUJDESJES DHE KUADRIT EDUKATIVO-ARSIMOR

Gjatë vitit shkollor planifikohet veprimtari profesionale për përkujdesje, kuadri edukativo-arsimor dhe punëtorët profesional realizohen nëpërmes formave dhe aktiviteteve në vijim:

- Teorike-profesionale përcjellja e literaturës profesionale dhe revistave profesionale të cilat i ka të furnizuara qendra. Të folurit dhe të luajturit në fushën edukativo-arsimorë (Nikolla Petrov dhe Vlladimir Mihajllowski), për zhvillimin dhe kulturën e të folurit, matematika NJFO për fëmijë për moshën parashkollore, Doracak për punën edukativo-arsimorë të fëmijëve parashkollor. “ Fëmijëria dhe lojërat” (nga Lolita Ristova), Arsimimi dhe kultura demokratike – praktika parashkollore, Doracak për edukatorë parashkollor (Fëmija si konsumator);

- Nëpërmes të formave të përsosmërisë profesionale ku bien edhe aktivitetet e lira dhe të drejtuara, nëpërmes kujt do të realizohet programi i punës edukativo-arsimorë;

- Udhëheqja e evidencës pedagogjike dhe e dokumenteve, si dhe realizimi i planit dhe programit prej të lartë përmendurit këshilla në qendër;

- Pjesëmarrja në këshillime dhe seminare që i organizon Enti pedagogjik, Biroja për zhvillim të arsimit në Republikën e Maqedonisë dhe të tjera institucione profesionale;

- Të tjera forma dhe aktivitete në përcjelljen e përparimit të punës edukativo-arsimorë do të organizohen varësisht nga nevojat që do ti kërkojë vetë puna dhe do të kontribuojë për përparimin profesional të më tu tejshtëm.

PROGRAMA PËR KUJDESIN E SHËNDETIT TË FËMIJËVE 2022/2023

Aktivitet shëndetësorë përmbajne katër segmente më te rëndësishme:

1. Kujdesi shëndetësor dhe parandalimi
2. Ushqimi i fëmijëve
3. Edukimi
4. Bashkpunimi me prindërit

Kujdesi shëndetësor dhe parandalimi përfshijnë:

- Kontrollat e rregullta mjekësore, diagnoza dhe marja e terapis së përshtatçme në fushën e stomatologjisë së fëmijëve.

- Kryerja e rehabilitimit sistematik të dhëmbëve tek fëmijët.

- Zbulimi i hershëm anomalive në gojën e fëmijëve , të dhëmbëve dhe marrjen e masave të duhura për trajnimin e tyre.

- Përkujdesja për riparimin e dhëmbëve të frakturuara tek fëmijët.

- Kontrollat sistematike nëpërmjet matjes së lartësis dhe peshës së fëmijëve me ndihmën e motrës medicinale dhe zbulimi i hershëm i anomalive tek fëmijët dhe marja e masave për trajnimin e tyre.

- Hapja e dosjes për çdo fëmijë i cili duhet të përmbajë të gjitha informatat të përgjithshme për fëmijën, gjendja gjatë lindjes , sëmundjet e kaluara infektive, sëmundjet

e rënda, alergjitë .Futen të dhënat për imunizim dhe vaksinimin me ndihmën e motrës medicinale.

- Kontrolla dhe evidentimi i sëmundjeve infektuese nëpër objektet.
- Bashkëpunim me audiologët e Qendrës për rehabilitimin e të folurit,ndëgjimit dhe zërit në Shkup.
- Bashkëpunim me pedagogun dhe psikologun e çerdhes.
- Bashkëpunim me Pediatratin e Klinikës së Kërçovës.
- Bashkëpunim me Institutin për kujdesin shëndetsor nëpërmjet planifikimit dhe realizimit të kontrollave sistematike të gjithë punëtorëve njëher në vjet përveç punëtorve të kuzhinës medoemos duhet të bëjnë kontrolla dyher në vjet.
- Bashkëpunim me qendrën për shërbimin publik.
- Kontrolla të rregullta të higjienës së objekteve punuese.
- Vazhdimisht kontrolla e kushteve mikroklimatike në kopsht.

Ushqimi për fëmijët:

- Plan për furnizimin me artikuj ushqimorë.
- Kontrollin e artikujve ushqimor të furnizuara.
- Përgatitja e listës mujore e ngrënies.
- Përgatitja e listës detajuar mujore të ngrënies.
- Bashkëpunim me agjencijonin për ushqim.
- Bashkëpunim me Drejtorin e ushqimit.
- Ndjekje në mënyrë kontinuale punën në kuzhinë.

Edukimi

- Edukimi i fëmijëve për ruajtjen e higjenës orale nëpër biseda individuale dhe ligjëratave edukuese.
- Edukimi i puntorve për ruajtjen e higjenës orale të tyre dhe të fëmijëve nëpërmjet bisedave individuale dhe ligjëratave edukuese.
- Edukimi i prindërve për ruajtjen e higjenës orale të fëmijëve nëpërmjet bisedave individuale dhe ligjëratave edukuese.
- Edukimi i fëmijëve për ruajtjen e higjienës personale nëpërmjet bisedave individuale dhe ligjëratave edukuese.
- Edukimi i fëmijëve për ushqimet e shëndetçme nëpërmjet ligjëratave edukuese.
- Mbajtja për fëmijë ligjërat edukuese tema,„Si sëmuremi dhe si sherohemi”.
- Mbajtja për fëmijë ligjërat edukuese tema,„Mikroorganizmat dhe si sëmuremi prej tyre”.
- Edukimi i prindërve se kur duhet të përdoren antibiotikët për shërimin e fëmijëve.
- Edukimi i puntorëve për ruajtjen e higjenës së kopshtit nëpërmjet bisedave individuale dhe grupore.

Bashkëpunim me prindërit:

Komunikimi i rregullt me prindërit e fëmijëve që qëndrojnë në objekt nëpërmjet bisedave individuale ,mbledhjeve prindërore,bisedave grupore ,educative për gjendjen shëndetsore të fëmijëve.

PROGRAMA PËR PUNË PËR FËMIJË ME NGEÇJE

PER VITIN 2022/2023

Natyra e problemeve	Qëllimet e mësimit	Strategjitë/materialet didaktike
Fëmijë me ngeçje në zhvillim	<p>- Respektimi i nevojave, interesave dhe mundësive të fëmijëve me aftësi të kufizuara</p> <p>- Theksimi i rëndësisë së zhvillimit të shpejtë të funksioneve njohëse dhe sferave të tjera psikologjike që kanë rëndësi të jashtëzakonshme për të gjithë fëmijët, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara</p> <p>-Krijimi i një klime të favorshme për bashkëveprimin ndërmjet një edukatori special për fëmijë</p> <p>Aftësimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara nga kategori të ndryshme për të kryer aftësi dhe ushtrime të caktuara</p> <p>Trajnim për të mbajtur vëmendjen e një veprimtarie dhe fëmijës për ta realizuar atë</p> <p>-Trajnimi për të ndjekur udhëzime të caktuara të dhëna nga eksperti (edukator special)</p> <p>Integrimi shqisor për fëmijët me aftësi të kufizuara zhvillimore</p> <p>Respekt për diversitetin</p> <p>Njohja e fëmijëve me vështirësi në të nxënë dhe zhvillim</p>	<p>- Përshtatja e materialit didaktik për realizimin e detyrave të diferencuara;</p> <p>-Puna individuale me fëmijë që kanë vështirësi në zotërimin e situatave, detyrave të caktuara;</p> <p>-Mbështetje udhëzuese e prindërve të fëmijëve për mënyrën e punës në mjedisin shtëpiak (në mënyrë që të përsëriten ushtrimet që janë mësuar gjatë qëndrimit në kopsht).</p> <p>-Bashkëpunim me familjen dhe komunikim të mirë modern</p> <p>-Informimi i prindërve për këshillimoren e hapur për fëmijë dhe prindër</p>

METODAT E PUNËS:

- metoda e lojës;
- metoda e vëzhgimit;
- metoda e hulumtimit;
- metoda e folururit (metoda monologjike, dialogu dhe diskutimi);

- metoda e shfaqjes (seri fotografish, objektesh, lodrash, aplikimesh, etj.);
- metodë ilustruese;
- metoda e punës praktike.

MATERIALET E PUNËS:

-Materiale arsimore që do të ndihmojnë në realizimin e detyrave të caktuara siç janë: (dërrasë e zezë, kube, stilolapsa me majë, shënues, kunja, shkopinj me ngjyra, figura gjeometrike, topa me ngjyra të buta, libra me fotografi të gjalla, enigma me shigjeta, gota plastike në plastelinë me ngjyrë ...)

REZULTATET E PRITURA:

Në varësi të aftësisë së kufizuar, fëmijët duhet të jenë në gjendje të zotërojnë ushtrime të caktuara

- Të mësojnë të shoqërohen
- Të mësojnë aftësi sociale
- Të jenë në gjendje të komunikojnë dhe bashkëpunojnë brenda aftësive të tyre me fëmijët e tjerë
- Të jenë në gjendje të bëjnë ushtrimet individualisht
- Të jetë në gjendje të kuptojë udhëzimet për kryerjen e ushtrimeve të caktuara nga eksperti (edukator special)
- Përfshirje më e madhe në grupin e bashkëmoshatarëve në aktivitetet në grup
- Përqendrimi i vëmendjes
- Zhvillimi i pavarësisë
- Të mësojnë të shprehin nevojat dhe dëshirat e tyre.

PROGRAMI PËR BASHKPUNIM ME MJEDISIN E GJËRË 2022/2023

Institucioni gjatë funksionimit të tij, duke krijuar cilësi hap dyert për çdo lloj bashkëpunimi që do të kontribuojë në përmirësimin e tij, përkatësisht do të vazhdojë të bashkëpunojë me institucione në nivel lokal dhe shtetëror:

- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale;
- Pushteti lokal;
- Byroja për zhvillimin e arsimit;
- kopshte nga qytete të tjera;
- shkollat fillore dhe të mesme komunale;
- Qendra ditore për personat me nevoja të veçanta;
- OJQ;
- institucionet publike-kulturore (biblioteka, teatër, muze);
- shtëpia e shëndetit;
- Instituti për Shëndetin Mendor të Fëmijëve dhe Rinisë - Shkup;
- media, etj.

**PROGRAMI
PËR AKTIVITETET PUBLIKE DHE KULTURORE
2022/2023**

Aktiviteti publik dhe kulturor në institucionin parashkollor synon të kontribuojë në realizimin sa më të plotë të detyrave të programit, si dhe në zhvillimin dhe pasurimin e jetës shoqërore dhe kulturore në institucion dhe në mjedis më të gjerë.

Në këtë drejtim, ne do të realizojmë veprimtarinë publike dhe kulturore përmes formave të mëposhtme:

1. Festimi 8 shtator - Dita e Pavarësisë së Republikës së Maqedonisë.
2. Festimi i Javës së Fëmijëve - Java e parë e Tetorit;
3. Përcjellja e vjeshtës - punëtori;
4. Festimi i Vitit të Ri dhe pritja e Baba Dimrit;
5. Festimi i Ditës së Gruas - ngjarje e brendshme, punëtori, shfaqje teatrale;
6. Festimi i 1 Prillit;
7. Dita e pranverës;
8. Pregatitja e urimeve-punëtori të Pashkëve;
9. Pjesëmarrja në garat e artit, festivalet e fëmijëve dhe ngjarje të ngjashme;
10. Ngjarja përfundimtare në të cilën marrin pjesë fëmijët që do të shkojnë në shkollë;
11. Festimi i ditëve ekologjike:
 - 22 Shtator - Dita Ndërkombëtare pa makina
 - 16 Tetor - Dita Botërore e Ushqimit;
 - Shkurt - muaji i shëndetit oral;
 - 21 Mars - Dita e Ekologjisë;
 - 7 Prill - Dita Botërore e Shëndetit;
 - 22 Prill - Dita e Tokës;
 - maj – muaj i trafikut.

**PROGRAMI
PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË KUADRIT
2022/2023**

Zhvillimi i shkencës sjell në mënyrë të pashmangshme nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional të stafit që realizon punën edukative. Edukimi i përhershëm dhe zhvillimi profesional do të kontribuojnë në përmirësimin e punës arsimore, si dhe në përmirësimin cilësor të njohurive të stafit arsimor dhe përkujdesës.

Për këtë qëllim, do të përfshihen punëtor shkencor të shquar, mjekë dhe bashkëpunëtorë të tjerë.

Në kuadër të zhvillimit profesional të stafit për këtë vit shkollor, planifikohen aktivitetet e mëposhtme:

1. Zhvillimi profesional në kopshtin e fëmijëve
Aktivi I edukatoreve dhe përkujdesëseve do të marrin pjesë dhe do të marrin pjesë në: prezantimin e projekteve të planifikuara, risitë, ligjëratat teorike dhe praktike, punëtoritë, letërsinë profesionale, etj.

Zbatuesit do të jenë profesionistë, edukatorë dhe profesionistë të tjerë të jashtëm kompetent.

2. Trajnim profesional jashtë kopshtit - në institucione të tjera parashkollore, të organizuar nga BDE, MPPS dhe shoqata joqeveritare.

3. Zhvillimi profesional individual - përdorimi i literaturës ekzistuese profesionale nga bibliotekat, si dhe gjetja dhe studimi i pavarur i letërsisë nga burime të tjera; pjesëmarrja në format e organizuara të shkëmbimit të përvojave dhe marrëveshjeve të punës me kolegë të tjerë, etj.

VEPRIMTARIJA SOCIALE

Përkujdesja e fëmijëve në çerdhe prej 9 muajsh deri në 5 vjet madhësi përkatësisht deri sa të shkojnë në shkollë çerdhja ka për qëllim që fëmijët ta ndjejnë si mes ku të gjitha fëmijët kanë të njëjtat mundësi të kyçen në jetë dhe punë pa marrë parasysh gjininë, përkatësinë nacionale dhe kulturën a me te arrihet qëllimi social.

Do të zhvillohen aftësi për adaptim në rreth të rinj, marrëdhëniet internacionale në mes individit dhe shkathtësive komunikuese. Do të zhvillohet ndërgjegjja e përkatësisë dhe marrëdhënia ka grupi si dhe zhvillimi e inteligjencies sociale. Fëmijët do të zhvillojë forma dhe shprehje në mese të ndryshëm dhe situata me çka fëmija sillet në vlera universale njerëzore dhe principe etnike.

Me vetë hyrjen në çerdhe fëmijët fillojnë të vendojnë lidhje të qëndrueshme emocionuese me një apo më shumë persona të rritur ose të moshës në rrethin e vet. Me këtë zvogëlohet intensiteti i acaruar, shqetësimi dhe frika prej ndarjes prej personave të afërt që nxit dhe fillon procesi i socializimit në kornizat e nevojave fëmimore. Në grup fëmija në mënyrë spontane do të fillojë të vendojë lidhje fëmijë-fëmijë, fëmijë-i rritur, të cilat kontakte shprehen si komunikim verbal dhe jo verbal.

Fëmijët do të aftësohen për të ruajtur ngjashmëri dhe dallime te vetvetja dhe të fëmijët tjerë, do të mësohen të përvetësojnë dhe respektojnë rregullat e sjelljes në grupe, do të njihen me dëshirat dhe interesat e fëmijëve të tjerë, do të njihen me normat elementare të moralit me të cilat rregullohen marrëdhëniet ka vetvetja dhe të tjerët siç janë: toleranca, bashkëpunimi, këmbëngulësia, pavarësia, drejtësia, ndershmëria, dashuria e vërtetë me çka do të pasurohet përvoja sociale dhe do të ndërtohet identiteti kulturor dhe kombëtar dhe me këtë fëmija do të aftësohet të gjejë vetveten në mesin e vet.

PROJEKTET

Projekti Inklluziv i fëmijëve Romë në qendrën parashkollore për herë të tretë do të realizohet në këtë vit shkollor.

Menjëherë pas aplikimit të suksesshëm do të kalojë ka implementimi i projektit dhe realizimi dhe planifikimi i aktiviteteve projektuese.

Për tu realizuar projekti i suksesshëm do të duhet të kyçen punëtorë profesional prej çerdes në bashkëpunim me Organizatën Joqeveritare vendore, përgëdhelsja e projektit dhe prindërit e fëmijëve të kyçur në projekt.

-Qëllimi i projektit

Të jepen të gjitha parakushtet për të shkuar në shkollë. Të përkujdesen fëmijët në mes që u mundëson të luajnë, të mësojnë, jetë të përbashkët, shoqërim-pa marrë parasysh

përcaktimin nacional, kyçje dhe stërvitje të prindërve të tyre prej informimeve të llojllojshëm dhe temave edukative.

Tjetër projekt që çerdhja e përcjell prej muajit Maj të këtij viti dhe planifikon ta përcjellë edhe më tutje është projekti Kuzhina Popullore për shfrytëzues me ndihmë sociale të përhershme. Ky projekt i Ministrisë për punë dhe politikë sociale dhe me vendim të Qeverisë përcillet nëpërmes të çerdhes, me atë që çerdhja e organizon dhe përgatit ushqimin e shfrytëzuesve.

Në këtë vit shkollor me porosi të Ministrisë për Punë dhe politikë sociale do të realizohen edhe katër projekte edhe atë: **Kopshte në kopshtet e fëmijëve, Qyteti nëpërmes syve të fëmijëve, Prej fëmijës për fëmijën dhe Bontoni për fëmijë.** Prej këtij viti nëpër drejtime nga MPPS do të realizohen edhe projektet në vijim: Aktivitetet sportive fizike në pajtim me arsyetimin profesionalo shkencor, riciklim me imagjinatën, familjen dhe vlerat familjare dhe higjiena e imë shprehitë e mija, Bashkpunim me komunitetet me te gjera shoqerore ne qytetin ton ,organizata jo qeveritare siq eshte Kryqi Kuq ,shoqata e pensionistve, aleanca e vezhgimit ,OJQ,ja vlen te jesh nga kercova ,klubi lajon,institucionet kulturore artistike etj.

-Kopshte në kopshtet e fëmijëve- Ushqimi i shëndosh është me rëndësi për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës. Marrëdhënia në ushqim është marrëdhënia ka jeta dhe për atë fëmijët duhet të jenë aktiv në marrëdhëniet e kultivimit të disa llojeve të zarzavateve dhe pemëve, me qëllim që të përcjellin procesin e formimit, përgatitjen dhe konsumimin e tyre. Dijenitë e përfituara në atë mënyrë janë afat gjata dhe përdorshme pasi japin bazë thelbësore në marrëdhëniet me natyrën dhe të mirat shpirtërore të rëndësishme për jetën e çdo individi, që jeton në harmoni me vetveten, rrethin e vet dhe punën dhe jo vetëm për qëllimin e vet por edhe për shoqërinë prej nga e ka edhe prejardhjen. Prej ku edhe sigurohet dhe përherë përmirësohet, ngrihet dhe zhvillohen dijenitë dhe vetëdija për domethënien e ushqimit të drejtë dhe të shëndosh te fëmijët, te të punësuarit dhe prindërit, përfitimi i shprehive për konsumimin e ushqimit të shëndosh dhe kualitativ si dhe shtytjen dhe zhvillimin e përgjegjësive te fëmijët për natyrën dhe obligimet kah vetvetja.

- **Qyteti nëpërmes të syve të fëmijëve-** Projekti “ Qyteti nëpërmes syve të fëmijëve” ka për qëllim zhvillimin e dashurisë, interesin, ndjenjat e patriotizmit, kujdesin dhe respektin kah atdheu, popullin, vendlindjen dhe vend jetesën, qëllimi i projektit është në përputhje me parimet dhe mundësitë e barabarta dhe respektimin e dallimin e fëmijëve dhe principet e multikulturalizmit të Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim. Aktivitetet edukativo arsimore janë të planifikuara me projektin për fëmijë të moshës nga 5-6 vjet dhe do të realizohen prej 1-një Tetor deri në fund të muajit Maj dhe ky projekt do të jetë pjesë përbërëse e planit vjetor dhe në vijim të viteve të ardhshme me projekte do të organizohen vizita me fëmijët prej qendrave publike të përmendoreve kulturo-historike prej të kaluarës dhe të sotmes të Shtetit tonë që do të angazhohen punëtor të artit figurativ dhe kyçje të fëmijëve dhe po ashtu edhe të prindërve.

- **Prej fëmijës për fëmijë-** projekti “ Prej fëmijës për fëmijë” do të jetë aksion humanitar prej fëmijëve për fëmijë nëpërmes moshës më të vogël do ti mësojmë më të vegjlit në humanizëm dhe solidaritet. Një prej qëllimeve të projektit është që fëmijët të mësojnë të jenë solidar të mësojnë të ndihmojnë të kuptojnë sa është me rëndësi shoqërimi dhe kushtimi i kujdesit për persona në rrezik social ngushëllim me ato që kanë nevojë për përkrahje, të mësojnë të respektojnë nevojat e fëmijëve. Ky projekt është në

drejtim që të sigurojë veshmbathje, dhurata, lojëra dhe të tjera pajisje fëmijërore e cila do të jetë e kushtuar për fëmijët e sëmur që janë të vendosur nëpër spitale dhe qendrat nëpër Republikë fëmijët prej kategorive të hershme dhe fëmijët pa kujdes prindëror.

-Bonton për fëmijë- Bontoni për fëmijët kuptohet në disa mënyra, që kërkohet prej tyre që ti bëjnë. Nëse vepohet në mënyrë ashtu siç kërkohet prej tyre atëherë do të llogariten si të edukuar, por nëse veprojnë në të kundërtën atëherë i llogarisim si jo të edukuar. Por fëmijët nuk i dinë rregullat për sjellje korrekte për atë shumë herë dhe jo për fajësim të tyre janë jo të pëlqyer. Rregullat e sjelljes që fëmija i ka mësuar në fëmijëri, me siguri do ti mbajë në mend tërë jetës. Mënyra intensive e jetës në të cilën jetojmë sot, mungesa e kulturës në sjellje, shkatërrimi i moralit dhe vlerat etike rezultojnë me ndryshimet e sjelljeve të të rriturve. Në garë për ekzistencë prindërit kanë shumë pak kohë që tu kushtojnë fëmijëve të tyre që në mënyrë të drejtë ti edukojnë dhe ti mësojnë. Këto situata sjellin te fëmijët që të mos kenë sjellje të kënaqshme dhe zhvillim të ndjenjave për jo durim, konflikte, mos respektim të personave të moshuar, prindërve, shokëve dhe miqve.

-Projekt për sport, fizikë, aktivitete motorrike

Në të gjitha programet për edukatë fizike dhe arsimim në aktivitetet tjera sportive zgjedhja në përmbajtjen programore ka vlerë primare për zhvillimin e drejtë antropologjik në zhvillimin e gjeneratës së re. Te fëmijët të të dy gjinive ushtrimet fizike dhe lojërat elementare në rend të parë duhej të jenë në zhvillimin e funksionit optimal të sistemit lokomotor. Në këto kushte është i domosdoshëm i organizimit fizik në entin ku loja duhet të jetë në rend të parë.

- Projekt “ Riciklim me imagjinatë”

Me këtë projekt bëhet edukimi i fëmijëve prej moshës parashkollore, për benifitet e seleksionimit të mbeturinave dhe riciklimit të tyre. Iniciativa e këtij projekti dhe kultura e përgjithshme e gjeneratave të reja dhe dijenitë për mesin jetësor është vlerë me rëndësi e cila duhet të mbrohet.

- Projekt “ Familja dhe vlerat familjare”

- Familja është rrënjë-thelbësore për çdo njeri. në familje lindim, i ndajmë kënaqësitë e para, i përvetësojmë shprehitë e para dhe mësojmë të duam dhe të respektojmë. Edukohemi me norma dhe vlera morale, takimi i parë me botën e jashtme fillon nga familja. Familja është bota kurse prindërit janë udhëheqës të ikonave dhe yjeve. Ajo duhet të kultivohet, ruhet dhe respektohet.

“Higjiena ime – shprehia ime”

Ky projekt është sistem për ruajtjen e higjienës dhe shprehitë higjienike. Kujdesi për higjienën është njëra prej masave bazë për ruajtjen e shëndetit. Nëpërmes të realizimit të procesit edukim-arsimor me programin për mësim të hershëm dhe zhvillim janë të paraparë masa dhe aktivitete për përmirësimin dhe ruajtjen e shëndetit të fëmijët.

FINANCIMI DHE POLITIKA VIJUESE E QENDRËS

Mjetet e financimit për mbrojtjen e fëmijëve do të sigurohen prej Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, pagesat e shërbimeve të shfrytëzuesve dhe burime të tjera në pajtim me ligjin.

Me këto mjete do të financohen:

- të drejtat dhe mbrojtja e fëmijëve;
- veprimtaria e qendrës publike;
- mirëmbajtja dhe pajisjet e objektit;
- aktivitete programore në forma të ndryshme për përparim dhe zhvillim të veprimtarisë;
- shërbimet.

Me mjetet për financim për mbrojtjen e fëmijëve udhëheq dhe disponon Ministria dhe qendra.

Mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe prej shfrytëzuesve do të sigurohen në bazë të programit për zhvillim të veprimtarisë për mbrojtjen e fëmijëve ku është caktuar shikimi, vëllimi, përmbajtja dhe kualiteti i shërbimeve, a do të harxhohen në mënyrë rigoroz e për qëllime të caktuara përpara të përgatitura me plan.

Për tu realizuar kjo do të kujdesen drejtori dhe shërbimet e kësaj fushe.

HARXHIMET MATERIJALE

Harxhimet materiale të parapara me planin financiar do të harxhohen për qëllime të caktuara.

Në bazë të Ligjit për furnizim publik do të kujdeset Komisioni për furnizim publik në bashkëpunim me të gjithë personat që janë profesional dhe kompetent.

Me shqyrtim të asaj se këto mjete më së tepërmi do të harxhohen për nevojat e fëmijëve në qendër do të mbahet llogari e repte për kualitetin.

Plani për furnizim publik varësisht nga nevojat e qendrës munden të ndryshohen dhe zgjerohen në përputhje me ligjin.

Shtator, viti 2022
Kërçovë

IPKKF-Çerdhja e fëmijëve
“Ollga Miseska”

SADIK AHMETI